

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6149
E martë, 27 tetor 2020
çmimi 0.40 €

Kurti: Zgjedhjet janë të domosdoshme



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", GAZMEND BYTYÇI

AKUZAT NDAJ THAÇIT DHE VESELIT DO TË HIDHEN POSHTË

- Nuk është diskutuar çështja e përfshirjes së PDK-së në qeveri



Deputeti i Partisë Demokratike i Kosovës (PDK), Gazmend Bytyçi, ka thënë se beson se do të hidhet poshtë propozimaktakuza ndaj Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit. Ai ka thënë se akuzat ndaj Thaçit, Veselit dhe luftëtarëve të tjerë të UÇK-së nuk

kanë asnjë bazë. Në këtë kontekst, Bytyçi ka bërë me dije se në forumet e PDK-së nuk është diskutuar asnjëherë përfshirja e kësaj partie në qeverinë Hoti. Në këtë intervistë për "Epokën e re", Bytyçi ka folur në lidhje me punën e komisionit hetimor parlamentar për

procesin e privatizimit. Ai ka thënë se pas intervistimit të dëshmitarëve do t'i vazhdojnë hetimet se kush janë përfituesit e privatizimeve në Kosovë. Ai ka theksuar se përfitues në procesin e privatizimit janë edhe eksponentë të LV-së dhe të LDK-së

AKTUALE

TË ENJTEN MBAHEN DY SEANCA, INTERPELANCAT PËR KRYEMINISTRIN S'JANË NË REND TË DITËS F. 3



ZGJEDHJET NË SHBA, "PËRCAKTUESE" PËR VAZHDIMIN E DIALOGUT F. 7

KGJK-JA VENDOS TË HAPË KONKURS PËR POZITAT E LIRA NË ADMINISTRATËN E GJYQËSORIT F. 6

RAMA: KODIN ZGJEDHOR DO TA VOTOJMË PA ASNJË NDRYSHIM F. 2

EKONOMI

COVIDI PRITET TË "FSHIJË" 8 MILIARDË EURO NGA EKONOMIA SHQIPTARE NË TRE VJET F. 9

AHMET SHALA MOHON TË JENË DJEGUR DOKUMENTET NË AKM F. 9

BLLOKOHEN XHIROLLOGARITË E TELEKOMIT F. 8



SPORT

MARMARINOS: DO TË PARAQITEMI MIRË NË NDESHJET E NËNTORIT F. 14

TRE TË VDEKUR DHE 205 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË

Në Kosovë janë konfirmuar të hënën edhe 205 raste të reja me koronavirus dhe tri viktima. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka treguar se gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 62 pacientë. Komuna me më së shumti të infektuar është Prishtina. Nga 205 raste të reja, 105 raste janë vetëm në



kryeqytet, kurse komuna e dytë me numrin më të madh të të infektuarve është Gjilani, me 12 raste të reja të infektimit

Thaçi nga Ozdrimi i Klinës: Erdha këtu për të treguar respekt për luftën e UÇK-së



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Mali i Zi, partitë e pakicave në bisedime për qeverinë e re

PODGORICË, 26 TETOR - Partitë e pakicave janë të ndara rreth pjesëmarrjes së tyre në qeverinë e ardhshme të Malit të Zi, e cila pritet të formohet së shpejti nga tre partnerët kryesorë: koalicionet "Për të ardhmen e Malit të Zi", "Paqja është kombi ynë" dhe "E zeza në të bardhë", të cilët në zgjedhjet e 30 gushtit kanë fituar shumicën. Ndonëse ka marrë ftesë për bisedime me të mandatarin për formimin e qeverisë së re, Zdravko Krivokapiq, koalicioni shqiptar "Bashkë një za" nuk është takuar, por përmes një përgjigjeje me shkrim, firmosur nga bartësi i listës dhe deputeti i këtij koalicioni, Fatmir Gjeka, e ka bërë të ditur qëndrimin e tij, raporton "VOA". "Ne nuk mund të jemi pjesë e qeverisë së Malit të Zi të cilën në mënyrë dominuese e përbëjnë ato parti dhe politika të cilat nuk dëshirojnë barazinë e shqiptarëve në këtë shtet dhe me të cilat dallojmë në mënyrë

diametrale në aspektin programor dhe strategjik", është thënë në përgjigjen e tij, duke renditur edhe një varg arsyesish të tjera.

Edhe Partia Boshnjake, e cila ka zhvilluar takim me Krivokapiqin, ka vendosur të mos jetë pjesë e qeverisë së re. Këshilli qendror i kësaj partie ka vendosur njëzëri kundër hyrjes në qeverinë e re me arsyetimin se në këtë moment politik ka vlerësuar se nuk duhet të jetë pjesë e qeverisë, por edhe për shkak të qasjes së ndryshme dhe dallimeve të caktuara ideologjike me disa prej pjesëtarëve të qeverisë së ardhshme.

Ndërsa përfaqësuesit e Listës Shqiptare, pas takimit që kanë zhvilluar me mandatarin Zdravko Krivokapiq, kanë publikuar kërkesat që i janë dorëzuar atij, duke thënë se ato janë kusht për pjesëmarrjen e tyre në Qeverinë e re të Malit të Zi. Bartësi dhe deputeti i Listës



Shqiptare, Nik Gjelogaj, ka deklaruar se disa nga kërkesat kryesore që janë të përfshira në platformën politike të këtij koalicioni bashkë me platformën ia kanë dorëzuar të mandatarit për formimin e qeverisë, Zdravko Krivokapiq.

Sipas tij, në këtë dokument të Listës Shqiptare përfshihen kërkesat që paraqesin kushtet për përfshirjen potenciale të Listës Shqiptare në qeverinë e ardhshme të Malit të Zi. Megjithatë, nuk dihet nëse këto kërkesa janë të

pranueshme dhe nëse Lista Shqiptare do të jetë pjesë e qeverisë. Në qeverinë në detyrë të Malit të Zi, të gjitha partitë e pakicave që ishin të përfaqësuara në Kuvendin e Malit të Zi, kanë qenë pjesë e saj.

Rama: Kodin Zgjedhor do ta votojmë pa asnjë ndryshim



TIRANË, 26 TETOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka deklaruar se Kodi Zgjedhor do të votohet sërish në Kuvend, pa asnjë ndryshim. Në një deklaratë për media, pas takimit me drejtuesit e Partisë Socialiste (PS) në qarqe, Rama ka deklaruar se askush nuk mund të vë në diskutim vullnetin e Kuvendit. "Do ta votojmë sa më

shpejt kur të caktohet seanca e votimit pa asnjë ndryshim, pikë dhe presje. Do ta votojmë Kodin siç është votuar nga parlamenti, me një shumicë që është kuptimplotë dhe askush nuk mund të verë në diskutim vullnetin e parlamentit, aq më tepër Ilir Meta", ka deklaruar Rama. Ai është pyetur edhe për sugjerimin e deputetes Rudina

Hajdarit për një mbledhje të Këshillit Politik, por ai është përgjigjur shkurt, duke përsëritur se Kodi Zgjedhor nuk do të pësojë asnjë ndryshim. Ditë më parë presidenti Ilir Meta ka kthyer në Kuvend për rishqyrtim Kodin Zgjedhor dhe është shprehur se do ta kërkojë edhe mendimin e Komisionit të Venecias.

Komisionari Varhelyi: Kuvendi ta presë opinionin e Komisionit të Venecias

TIRANË, 26 TETOR - Komisionari për fqinjësinë dhe zgjerimin në Komisionin Evropian, Oliver Varhelyi, ka reaguar pasi presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka kërkuar opinionin e Komisionit të Venecias lidhur me Kodin Zgjedhor që ka miratuar në Kuvendin shqiptar. Përmes një postimi në "Twitter", ai ka thënë se beson që Venecia do t'u kthejë shpejt përgjigje palëve të interesuara në Shqipëri me këshilla për këtë çështje. Ndër të tjera,

komisionari evropian ka kërkuar nga Kuvendi që ta presë opinionin e Venecias në lidhje me ndryshimet në kodin zgjedhor. "Unë besoj se Komisioni i Venecias do të japë këshilla të shpejta për palët e interesuara mbi zbatimin e ndryshimeve kushtetuese të 30 korrikut. Kuvendi duhet ta marrë në konsideratë këtë këshillë. Mezi po pres t'i shoh zgjedhjet e lira dhe të ndershme në prill 2021", ka shkruar Varhelyi.



Rritet numri i të infektuarve me Covid-19 në Kosovë

Tre të vdekur dhe 205 raste të reja me Covid në Kosovë

Në Kosovë janë konfirmuar të hënën edhe 205 raste të reja me koronavirus dhe tri viktima. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka treguar se gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 62 pacientë. Komuna me më së shumti të infektuar është Prishtina. Nga 205 raste të reja, 105 raste janë vetëm në kryeqytet, kurse komuna e dytë me numrin më të madh të të infektuarve është Gjilani, me 12 raste të reja të infektimit



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 26 TETOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se brenda 24 orëve të fundit janë regjistruar tri viktima nga koronavirusi. Në njoftimin për media, IKShPK-ja ka treguar se gjatë kësaj periudhe kohore janë regjistruar 205 raste të reja të infektimit me Covid-19. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 943 mostra të marra

nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 205 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar tri raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv (1 rast Spitali i Përgjithshëm Pejë, Spitali i Përgjithshëm Prizren dhe Spitali i Përgjithshëm Gjakovë)", ka bërë me dije IKShPK-ja. Sipas institutit, nga koronavirusi janë shëruar edhe 62 pacientë. "Numri total i rasteve pozitive është 18 148 raste nga 88 090 persona të dyshimta me virusin SARS-CoV-2 dhe 666 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 62 pacientë, kurse

numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 15 150 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 2 332", është thënë në njoftimin e institutit.

Komuna me më së shumti të infektuar është Prishtina. Nga 205 raste të reja të infektimit me Covid-19, 105 raste janë vetëm në Prishtinë. Ndërsa komuna e dytë me numrin më të madh të të infektuarve është Gjilani, me 12 raste të reja. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 111 raste, komuna Gjilani 18 raste, komuna Gjakovë 13 raste, komuna Ferizaj 10 raste, komuna Pejë 10 raste, komuna Fushë-Kosovë 6 raste, komuna e Lipjan 6 raste, komuna Obiliq 6 raste, komuna Klokot 4 raste, komuna Prizren 4 raste, komuna Viti 3 raste, komuna Deçan 2 raste, komuna Drenas 2 raste, komuna Malishevë 2 raste, komuna Podujevë 2 raste, komuna Shtime 2 raste dhe me nga një rast komunat Graçanicë, Kamenicë, Rahovec dhe Skenderaj", ka treguar IKShPK-ja, duke i ftuar qytetarët e Kosovës që ta mbajnë maskën dhe ta respektojnë distancën.

AHMETI: NUK KEMI NEVOJË PËR SHTRËNGIM TË MASAVE ANTI-COVID

Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, e ka komentuar situatën pandemike në vend dhe kryeqytet. Ai ka thënë se gjendja me Covid-19 në vend është e menaxhueshme, por duhet të bëhet kujdes. "Shtetet fqinje po ballafaqohen me numra alarmantë të virusit. Vetëm dje Maqedonia ka pasur mbi 600 raste të reja dhe 22 viktima. Shumë shtete evropiane po ballafaqohen me mbyllje të reja për shkak të numrave alarmantë. Kosova duhet të jetë në dilemë në mungesë të hulumtimeve. Para një muaji kemi pasur një krizë të madhe dhe numra të lartë në krahasim me fqinjët. Zakonisht kemi qenë 2-3 javë me vonesë në krahasim me shtetet e tjera. Kësaj radhe disa po shpresojnë se krizën që tani të tjerët po e kalojnë e kemi kaluar para një muaji", ka shkruar Ahmeti në profilin e vet në "Facebook". Duke marrë parasysh rrezikun dhe lidhshmërinë me shtetet

fqinje, Ahmeti ka vlerësuar se duhet pasur kujdes të shtuar. Megjithatë, ai ka thënë se vendi nuk ka nevojë për shtrëngim të masave anti-Covid. "Posaçërisht pas rritjes së numrave të ne në mbi 130 në ditë. Disa mund të jenë pasojë e hapjes së shkollave, por tani ekziston edhe rreziku i bartjes së virusit edhe më shumë nga shtetet fqinje. Udhëtimi pa viza mund të jetë edhe një prej arsyeve pse shtetet fqinje kanë më shumë infeksione tani. Keni kujdes këto ditë! Tashmë i dini masat e mbrojtjes. Shkollat po mbyllen në momentin kur më shumë se 5 për qind e stafit janë të infektuar me virus. Kjo po mban numrat në nivel të menaxhueshëm. Nuk kemi nevojë për mbyllje e restriksione shtesë nga qeveria. Kemi nevojë që vatrat të identifikohen dhe të trajtohen", është shprehur Ahmeti, duke komentuar edhe gjendjen pandemike në kryeqytet: "Prishtina ka disproporcionalisht më shumë testim, prandaj edhe komunat e tjera nuk bën të relaksohen sepse si përqindje e testeve, jemi të gjithë në një nivel".



Të enjten mbahen dy seanca, interpelancat për kryeministrin s'janë në rend të ditës

PRISHTINË, 26 TETOR (ER) - Kryesia e Kuvendit e Kosovës ka vendosur të hënën që të enjten të mbahen dy seanca parlamentare. Pas mbledhjes, kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, ka treguar se në rend të ditës nuk do të jenë dy interpelanca për kryeministrin Avdullah Hoti. "Ne vendosëm për seancën e radhës në konsultim me shefat e grupeve parlamentare për

këtë të enjte. Do ta vazhdojmë votimin e pikave të rendit të ditës për të cilat s'ka pasur kuorum për vendimmarrje në seancat e kaluara. Kurse në orën 11:00 do të kemi seancë të re", ka thënë Osmani. Lidhur me interpelancat e kryeministrit Avdullah Hoti, ajo ka bërë me dije se nuk kanë gjetur ende një datë të përbashkët me kabinetin e tij. "Sa i përket interpelancave me

kryeministrin, njëra që ka të bëjë me liqenin e Ujmanit dhe tjetra që ka të bëjë me trajtimin e dëmshëm të temës së të pagjeturve, që janë shtruar nga deputetë të IV-së. Për këto do ta vazhdojmë komunikimin me kabinetin e kryeministrit që të gjejmë një datë të përshtatshme. Deri tani nuk kemi pasur pajtim për datë", ka deklaruar Osmani.



Flet për “Epokën e re”, Gazmend Bytyçi

AKUZAT NDAJ THAÇIT DHE VESELIT DO TË HIDHEN POSHTË

Deputeti i Partisë Demokratike i Kosovës (PDK), Gazmend Bytyçi, ka thënë se beson se do të hidhet poshtë propozimaktakuza ndaj Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit. Ai ka thënë se akuzat ndaj Thaçit, Veselit dhe luftëtarëve të tjerë të UÇK-së nuk kanë asnjë bazë. Në

këtë kontekst, Bytyçi ka bërë me dije se në forumet e PDK-së nuk është diskutuar asnjëherë përfshirja e kësaj partie në qeverinë Hoti. Në këtë intervistë për “Epokën e re”, Bytyçi ka folur në lidhje me punën e komisionit hetimor parlamentar për procesin e

privatizimit. Ai ka thënë se pas intervistimit të dëshmitarëve do t'i vazhdojnë hetimet se kush janë përfituesit e privatizimeve në Kosovë. Ai ka theksuar se përfitues në procesin e privatizimit janë edhe eksponentë të LV-së dhe të LDK-së

- Nuk është diskutuar çështja e përfshirjes së PDK-së në qeveri

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 TETOR - Nën kryetari i Komisionit Parlamentar për Hetim të Privatizimit, njëherësh deputet i Kuvendit të Kosovës nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK-së), Gazmend Bytyçi, ka bërë me dije se pas intervistimit të dëshmitarëve të këtij procesi, do të vazhdojnë hetimet se kush janë përfituesit e privatizimit në vendin tonë. Bytyçi në këtë intervistë për “Epokën e re” ka thënë se padrejtësisht PDK-ja është vënë në shënjestër të sulmeve në lidhje me privatizimet. “PDK-ja është vënë në shënjestër të sulmeve të ndryshme, duke na akuzuar se jemi keqpërdoruesit më të mëdhenj në procesin e privatizimit e, në fakt, ne pretendojmë dhe besojmë se

është krejtësisht e kundërta”, ka thënë Bytyçi. Në këtë kontekst, Bytyçi ka thënë se eksponentët e Vetëvendosjes dhe LDK-së janë të lidhur me procesin e privatizimeve. “Në opinion po qarkullojnë disa lista dhe disa emra dhe nga ajo çfarë kam parë, janë lista të sakta dhe janë shumë eksponentë të partive të tjera, të Lidhjes Demokratike të Vetëvendosjes etj., që janë privatizues, por ne nuk do ta akuzojmë askënd se janë apo jo keqpërdorues të këtij procesi. Që janë privatizues, kjo është e vërtetë”, ka deklaruar Bytyçi. Më tutje, Bytyçi ka folur rreth raportimeve në media për përfshirjen e PDK-së në qeverinë e drejtuar nga Avdullah Hoti. Ai ka bërë me dije se në forumet e PDK-së nuk është diskutuar asnjëherë përfshirja e kësaj partie në qeveri. “Deri më tani mund t’ju them me përgjegjësi të plotë se



në të gjitha forumet ku unë marrë pjesë, flas edhe për mbledhjet e grupit parlamentar të PDK-së, kjo çështje nuk është diskutuar”, ka thënë Bytyçi. Deputeti i PDK-së ka komentuar edhe propozimaktakuzën e Gjykatës

Speciale kundër presidentit Hashim Thaçi dhe liderit të partisë së tij, Kadri Veseli. Bytyçi ka thënë se beson se do të hidhet poshtë propozimaktakuza ndaj Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit.

“Epoka e re”: Z. Bytyçi, si është duke shkuar puna në Komisionin Hetimor për Privatizim?

Bytyçi: Ky komision është iniciuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe kryetari Kadri Veseli. Qëllimi i këtij

Kurti: Zgjedhjet janë të domosdoshme

PRISHTINË, 26 TETOR (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se rikthimi i qeverisjes së mirë është i nevojshëm për Kosovën. Sipas tij, vonesa e kësaj, por edhe e zgjedhjeve të reja, gjithnjë po bëhet më e pamundur. Këto komente Kurti i ka bërë pas aderimit në Vetëvendosje të Florije dhe Valentina Rexhës. “Florije Rexha dhe Valentina

Rexha, nënë e bijë me prejardhje nga Gjakova, u anëtarësuan në Vetëvendosje! I mirëpritur në takim bashkë me aktivisten e Lëvizjes, Esma Bunjaku. Znj. Florije pas luftës migroi në Gjermani, ku edhe jeton tani me djalin e saj dhe familjen e tij. Ndërsa Valentina, e cila përfundoi studimet universitare në drejtimin e Arkitekturës në Prishtinë,

migroi në mes të viteve '90 në Gjermani, e në 2006-n u kthye në Kosovë. Valentina është sipërmarrëse dhe themeluese e disa kompanive vendore, të cilat bashkëpunojnë me kompani të ndryshme evropiane në tregti dhe industri të lehtë. Lëvizja është shumica. Rikthimi i qeverisjes së mirë është aq i nevojshëm, kurse zgjedhjet dhe



ndryshimet janë të këtyre po bëhet gjithnjë e më i domosdoshme. E vonimi i pamundur”, ka theksuar Kurti.

komisioni është zbardhja e të gjithë procesit të privatizimit që ka ndodhur nga viti 2001 e deri më tani. Dhe arsyeja është që të shihet se a janë respektuar procedurat dhe sa ka pasur transparencë në këtë proces. Po ashtu, qëllimi i këtij komisioni është të shihet edhe ndikimi i politikës dhe grupeve të interesit, siç interpretohet vazhdimisht në opinion. Ne konsiderojmë se padrejtësisht PDK-ja është vënë në shënjestër të sulmeve të ndryshme, duke na akuzuar se jemi keqpërdoruesit më të mëdhenj në procesin e privatizimit e, në fakt, ne pretendojmë dhe besojmë se është krejtësisht e kundërta. Në fakt, janë partitë e tjera politike

ekspertë të ekonomisë, në kuadër të grupit parlamentar e që, në fund, besoj se do të dalim me një raport përfundimtar në Kuvendin e Kosovës. Çështja e këtij komisioni është se ne jemi në gjysmë të kohës, pasi një komision hetimor mund të punojë deri në gjashtë muaj dhe jo më shumë. Tani jemi në fazën e intervistimit, ku kemi pasur dëshmitarë, kryesues, anëtarë të bordeve që kanë qenë drejtpërdrejt të përfshirë në këtë proces. Prej shumicës prej tyre kemi marrë vlerësimin profesional, por edhe për disa çështje që po dalin se kanë qenë problematike për kohën.

“Epoka e re”: *Është paralajmëruar befasi nga ky komision sa iu përket privatizuesve. Përveç listës që qarkulloi në media, çfarë tjetër mund të na thoni?*

Bytyçi: Në opinion po qarkullojnë disa lista dhe disa emra dhe nga ajo çfarë kam parë, janë lista të sakta dhe janë shumë eksponentë të partive të tjera, të Lidhjes Demokratike të Vetëvendosjes etj., që janë privatizues, por ne nuk do ta akuzojmë askënd se janë apo jo keqpërdorues të këtij procesi. Që janë privatizues, kjo është e vërtetë. Çështje tjetër që ne do ta fillojmë pjesën e hetimeve është që ta shohim se kush kanë qenë përfitues. A kanë qenë familjarë të tyre apo është dikush nga personat politikë dhe publikë e që do të jetë një fazë tjetër pas përfundimit të intervistimit të dëshmitarëve. Por, ne do ta hetojmë edhe pjesën e ndërmarrjeve që nuk i kanë përmbushur kushtet e kontratës. Pra, nuk është vetëm çështja e privatizimit, por edhe e obligimit që kanë pasur ndërmarrjet e privatizuara ndaj punëtorëve. Si komision jemi duke pranuar ankesa të ndryshme nga punëtorët e atyre ndërmarrjeve të cilët ankohen në këtë proces për shkelje të të drejtave bazë të tyre.

“Epoka e re”: *A jeni të bashkuar me partitë në pushtet në këtë proces?*

Bytyçi: Në fakt, në Kuvend është mirëpritur ky propozim i PDK-së. Është votuar nga deputetët pro hetimit të procesit të privatizimit dhe ka pasur një tendencë të partive të tjera,

Vetëvendosja dhe LDK-ja nuk e mbajtën fjalën për Ligjin për vlerat e UÇK-së

“Epoka e re”: *Z. Bytyçi, keni iniciuar në Kuvend Projektligjin për mbrojtjen e vlerave të UÇK-së, por në mungesë të votave nuk është duke arritur të miratohet. Çfarë është duke ndodhur?*

Bytyçi: Edhe ky projektligj është iniciuar nga PDK-ja, konkretisht nga ana ime. Kemi punuar një kohë të gjatë para se të vijë në Kuvend dhe për tre muaj kemi pasur një bashkëpunim të mirë me të gjitha partitë politike. Në këtë drejtim patëm marrë premtime

se do ta votojnë këtë projektligj dhe nuk kanë pasur asnjë lloj ankese. Por në momentin e fundit Vetëvendosja dhe LDK-ja janë tërhequr, madje për më keq i kanë dezinformuar qytetarët dhe opinionin se me këtë ligj ne po bëjmë dëme të caktuar te liria e shprehjes etj. Por, të gjitha këto janë duke u bërë vetëm sa për ta arsyetuar mosvotimin e tyre. Ne ishim dhe jemi të hapur që t'i marrim parasysh komentet tyre, megjithëse ende nuk kemi asgjë konkrete me shkrim. Ky

projektligj ka kaluar nga zyrat e Kuvendit dhe qeverisë, është rikthyer në komisionin funksional, e që sërish e ka marrë dritën jeshile. Po ashtu, kemi pasur tryezë të përbashkët me të gjitha partitë politike, edhe pse nuk është obliguese, por kishim dëshirë t'i ofrojmë të gjithë. Po ashtu kemi pasur bashkëpunim edhe me shoqatat e dala nga lufta. Përkundër premtimeve që kemi pasur se do ta votojnë këtë projektligj, është duke ndodhur e kundërta.

sidomos të Vetëvendosjes që të tentojë të krijojë çështje të tjera, por ne kemi konsideruar se duhet t'i përmbahemi autorizimit çfarë na ka dhënë Kuvendi. Deri më tani, konsideroj se është duke u punuar me frymë bashkuese dhe anëtarët e komisionit janë të interesuar dhe janë duke punuar që ta zbardhin këtë çështje.

“Epoka e re”: *Raporti i Progresit ka dhënë vërejtje për punët e komisioneve hetimore. Çfarë epilogu prisni që do të ketë ky komision?*

Bytyçi: Ne do të punojmë që ky komision të dalë me një raport sa më të hollësishëm i cili do të ketë informacione sa më përmbledhëse për këtë proces. E kuptojmë vështirësinë dhe kompleksitetin, pasi po flasim për shitjen e afër tre mijë ndërmarrjeve dhe për një kohë gjashtëmuajore të hetohen të gjitha këto është e pamundur, por faza tjetër që do të vijë pas intervistimit është se do të fillojmë t'i hetojmë dhe merremi me rastet specifike ku është raportuar dhe ka fakte për abuzime. Unë nuk po flas për punën e komisioneve të tjera sa i përket Raportit të Progresit, por po flas për këtë komision i cili është duke bërë punë goxha të madhe. Për shkak të rëndësisë që e ka, ne kemi

vendosur që në fokus kryesor ta kemi këtë komision.

“Epoka e re”: *Z. Bytyçi, të ndalemi pak te Projektligji për Rimëkëmbje Ekonomike. Ky projektligj nuk është përkrahur nga PDK-ja, edhe pse ka kaluar në lexim të parë. A keni ndryshuar qëndrim sa i përket këtij dokumenti kur ai pritet të dalë për diskutim dhe votim në lexim të dytë?*

Bytyçi: Ne nuk kemi qenë kundër pakos së rimëkëmbjes asnjëherë. Ne kemi dhënë variante edhe më të mira sa i përket tërheqjes së mjeteve nga Trusti, por ka qenë mosgatishmëria e qeverisë që të bashkëpunojë me PDK-në dhe grupin tonë parlamentar për t'i marrë parasysh vërejtjet tona. Thjesht, konsiderojmë se kjo qeveri e ka keqpërdorur mirësinë e PDK-së edhe pse si opozitë kemi votuar edhe rishikimin e buxhetit edhe marrëveshjet financiare ndërkombëtare dhe ata nuk i kanë marrë për bazë asnjëherë këshillat dhe vërejtjet tona. Prandaj nuk mund të funksionojmë me këtë formë të qeverisë që lanson në opinion gjoja një pako për rimëkëmbje ekonomike, e që më së paku ka të bëjë me rimëkëmbje. Qëndrimet tona janë të njëjta, përderisa nuk e dimë a do të merren parasysh dhe a do të

amendamentohen propozimet tona në kuadër të kësaj pakoje.

“Epoka e re”: *Vazhdimisht po qarkullojnë zëra se PDK-ja do të bëhet pjesë e qeverisë Hoti. Jeni duke diskutuar në forume të partisë që të jeni pjesë e ekzekutivit?*

Bytyçi: Deri më tani mund t'ju them me përgjegjësi të plotë se në të gjitha forumet ku unë marrë pjesë, flas dhe për mbledhjet e grupit parlamentar të PDK-së, kjo çështje nuk është diskutuar.

“Epoka e re”: *Z. Bytyçi, ende nuk është dhënë ndonjë verdikt nga Gjykata Speciale sa i përket propozimaktakuzës së Thaçit dhe Veselit. Si jeni duke e parë këtë proces?*

Bytyçi: Unë personalisht, por edhe PDK-ja besojmë se shumë shpejt do të jepet verdikti dhe do të hidhen poshtë të gjitha pikat e aktakuzës për të cilat nuk ka fare bazë jo vetëm për Thaçin dhe Veselin, por për të gjithë bashkëluftëtarët tanë dhe të gjithë pjesëtarët e UÇK-së.

“Epoka e re”: *Të themi në rastin më të keq, nëse konfirmohet aktakuza ndaj z. Veseli, a është diskutuar brenda PDK-së se kush potencialisht mund ta zë vendin e tij?*

Bytyçi: Jo dhe as që e kemi marrë parasysh këtë çështje.

Thaçi nga Ozdrimi i Klinës: Erdha këtu për të treguar respekt për luftën e UÇK-së

KLINË, 26 TETOR (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, bashkë me përfaqësuesit e OVLUÇK-së ka zbuluar pllakën në kullën e rezistencës së familjes Imeri në Ozdrim të Klinës. Ai ka thënë se ka qëndruar në Ozdrim për të treguar respekt për luftën e

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). “Në fshatin Ozdrim të Klinës, me përfaqësuesit e OVLUÇK-së e zbuluam pllakën në kullën e rezistencës së familjes Imeri, ku gjatë luftës morëm vendime të rëndësishme. Erdha sot këtu për të treguar respekt për luftën

e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për rezistencën e Ozdrimit me rrethinë dhe për të gjithë heronjtë, dëshmorët dhe martirët që dha kjo trevë. Lavdi të gjithë të rënëve për liri dhe pavarësi!”, ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në “Facebook”.



Policia konfirmon dorëzimin e Kadri Shalës

PRISHTINË, 26 TETOR (ER) - Policia e Kosovës ka konfirmuar dorëzimin e Kadri Shalës, pronarit të kompanisë "LDA Group", ku kanë shkuar rreth 2.1 milionë eurot e shtetit nga disa transakcione ilegale. Policia ka bërë me dije se Shala është duke u intervistuar. "Lidhur me rastin e poshtëshënuar, sot në Policinë e

Kosovës është vetëdorëzuar një mashkull kosovar i cili tani është në proces të intervistimit. Policia e Kosovës të gjitha veprimet e mëtejme lidhur me rastin dhe personin në fjalë do t'i ndërmarrë në konsultim dhe koordinim me prokurorin kompetent", ka bërë me dije Policia e Kosovës.



Dënohet me burgim të përjetshëm personi që vrau dhe më pas dogji trupin e shokut

PRISHTINË, 26 TETOR - Gjykata Themelore në Ferizaj e ka dënuar me burgim të përjetshëm, të akuzuarin T. L. për vrasjen e kryer në dhjetor të vitit 2019. Gjykata ka konstatuar se i akuzuari me dashje, në mënyrë dinake dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, kishte privuar nga

jeta Shkodran Bytyqin. Bytyqi ishte vrarë më 8 dhjetor 2019 në fshatin Surqinë, e më pas i dyshuari kishte marrë trupin e viktimës dhe e kishte dërguar në fshatin Kishnapole të Gjilanit. T. L. dyshohet se ishte kthyer përsëri në këtë fshat dhe ia kishte vënë zjarrin kufomës së Bytyqit.



KGJK-ja vendos të hapë konkurs për pozitat e lira në administratën e gjyqësorit

PRISHTINË, 26 TETOR (ER) - Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka autorizuar sekretariatit që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për iniciimin e procedurave për shpalljen e pozitave të lira në administratën e gjyqësorit, duke u bazuar në Ligjin për buxhetin e vitit 2020. Ky këshill nëpërmjet një komunikate ka njoftuar se është aprovuar propozimi i kryetarit të Gjykatës Supreme për emërimin, përkatësisht vazhdimin e mandatit të gjyqtarit Rasim Rasimi si anëtar/kryesues i Panelit për Lirim me Kusht dhe gjyqtarit Beshir Islami, si anëtar rezervë, me mandat dyvjeçar. "Gjatë këtij takimi anëtarët e KGJK-së aprovuan dorëheqjen nga pozita e gjyqtarit porotë në

Gjykatën Themelore në Gjilan, Sejdi Beqiri. Këshilli aprovoi draftvendimin për kompensimin e anëtarëve të KGJK-së. Këshilli autorizoi drejtorin e përgjithshëm të SKGJK-së që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për iniciimin e procedurave të rekrutimit për plotësimin e pozitave të lira në administratën e gjyqësorit për shpalljen e pozitave të lira në administratën e gjyqësorit bazuar në Ligjin për buxhetin e vitit 2020. Kryesuesi Skender Çoçaj njoftoi anëtarët e këshillit lidhur me procesin e rishikimit funksional të sundimit të ligjit, rreth të cilit ata do t'i pranojnë dokumentet e fundit të përgatitura nga Ministria e Drejtësisë, me qëllim që secili të kontribuojë me analiza dhe



komente, pasi që është një proces mjaft i rëndësishëm për

gjyqësorin e Kosovës dhe pritet të diskutohet në mbledhjen e

radhës së KGJK-së", është thënë në komunikatën e KGJK-së.

Kosnetti përgëzon Kosovën për anëtarësimin në iniciativën e thirrjes globale për fuqizimin ekonomik të grave



PRISHTINË, 26 TETOR (ER) - Ambasadori ShBA-së në Kosovë, Philip S. Kosnett, ka përgëzuar Kosovën për anëtarësimin në iniciativën e Thirrjes Globale për Veprim për Fuqizimin Ekonomik të Grave, të udhëhequr nga ShBA-ja. Në llogarinë e tij në "Twitter", ai ka shkruar se gjatë

historisë së Kosovës, udhëheqëset femra kanë dhënë kontribut të rëndësishëm për qeverinë dhe shoqërinë. "Ne e përgëzojmë Kosovën për anëtarësimin në këtë nismë. Gjatë historisë së Kosovës, udhëheqëset femra kanë dhënë kontribut të rëndësishëm për qeverinë dhe

shoqërinë. Sidoqoftë, mbetet shumë punë për t'u siguruar që gratë mund të participojnë në ekonomi plotësisht dhe lirisht", ka shkruar Kosnett, ku ka bashkangjitur edhe një video të ministres së Punëve të Jashtme, Meliza Haradinaj, duke e hedhur nënshkrimin në deklaratën zyrtare.

Zgjedhjet në ShBA, 'përcaktuese' për vazhdimin e dialogut

Dialogu i ndërmjetësuar nga BE-ja në mes të Kosovës dhe Serbisë është bllokuar sërish për shkak të asociacionit të komunave me shumicë serbe. Pavarësisht prej kësaj gjendjeje, vazhdimi i dialogut në mes të dy shteteve është duke u ndërlidhur edhe me zgjedhjet presidenciale në ShBA. Engjëllushe Morina, eksperte në Organizatën e Këshillit Evropian për Politikë të Jashtme (ECFR), me seli në Berlin, ka vlerësuar se dialogu nuk do të vazhdojë deri në qartësimin e asaj se kush do t'i fitojë zgjedhjet presidenciale në ShBA

PRISHTINË, 26 TETOR - Dialogu i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian për normalizimin e raportëve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është bllokuar sërish, pasi palët nuk po pajtohen për temën e asociacionit të komunave me shumicë serbe. Takimi i fundit në nivel liderësh në Bruksel është mbajtur më 7 shtator, tri ditë pas nënshkrimit të marrëveshjes së Uashingtonit. E fakti se kush do të jetë në udhëheqje të Shtëpisë së Bardhë në Uashington, pas zgjedhjeve presidenciale të 3 nëntorit, po shihet si përcaktues edhe për vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi. Engjëllushe Morina, eksperte në organizatën Këshilli Evropian për Politikë të Jashtme (ECFR), me seli në Berlin, ka vlerësuar se dialogu nuk do të vazhdojë deri në qartësimin e asaj se kush do t'i fitojë zgjedhjet presidenciale në ShBA. "Nuk besoj se do të ketë lëvizje në këtë proces, deri diku kah mesi i nëntorit më së hershmi. Kjo varet shumë nga rezultati i zgjedhjeve në ShBA dhe ky rezultat do ta ketë rolin e vet në dinamikën e procesit dialogues ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, pasi së fundmi ShBA-ja ndërmori edhe një iniciativë për normalizimin e marrëdhënieve prej këndit ekonomik", ka thënë Morina për "Radion Evropa e Lirë". Ndërsa Jeta Krasniqi nga

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka thënë se nuk pret që rifillimi i dialogut të varet tërësisht nga zgjedhjet në ShBA. Sidoqoftë, ajo e sheh të pashmangshëm koordinimin e plotë ShBA-BE për arritjen e marrëveshjes finale. "Tani dialogu Kosovë - Serbi është në tryezën e BE-së dhe duhet të shihet se si mund të zhblokohet për të ecur përpara. Por, një marrëveshje finale duhet ta ketë edhe mbështetjen e ShBA-së dhe pritet të kemi një pjesëmarrje të ShBA-së, pasi pa pjesëmarrjen e saj nuk do të kemi një marrëveshje që do të arrijë te njohja reciproke, anëtarësimi i Kosovës në OKB (Organizata e Kombeve të Bashkuara) dhe të gjitha ato të tjerat që ne i kërkojmë nga ky proces", ka thënë Krasniqi për "Radion Evropa e Lirë". Por, ajo ka thënë se që BE-ja do të dalë me një plan për ta zhblokuar dialogun dhe për ta shtyrë përpara atë. Liderët e Kosovës dhe të Serbisë në shtator nënshkruan në Uashington marrëveshje për normalizim ekonomik. Engjëllushe Morina ka thënë se shumëkush nuk e cilëson marrëveshje atë që është nënshkruar më 4 shtator, por si nënshkrim të dy dokumenteve të veçanta. Prandaj, ajo nuk është e bindur se "nënshkrimet e Uashingtonit" do të sjellin rezultat pasi, sipas saj, aty nuk u trajtuan çështjet kryesore.



Brendan Smielowski (AFP)

"Është vështirë që të besohet (koha do ta tregojë) se shtytjet ekonomike i përmirësojnë marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ka çështje shumë të rëndësishme për të dyja palët dhe veçmas për palën e Kosovës dhe ato nuk janë ekonomike", ka thënë Morina.

Qeveria aktuale e Kosovës, e udhëhequr nga kryeministri Avdullah Hoti, është në minimum të shumicës parlamentare dhe po përballet me një opozitë të fortë, e cila nuk po e mbështet në dialog. Analistët kanë thënë se Kosova duhet të ketë kohezion politik për t'i arritur synimet e saj. "Ajo çka duhet të ndryshojë është gjetja e një kohezioni politik, edhe në Kosovë edhe në Serbi, që të ketë një ide se çka janë pritjet e palëve në dialog dhe të sqarohen principet kryesore të dialogut", ka thënë Engjëllushe Morina nga ECFR-ja.

Kurse Jeta Krasniqi ka vlerësuar se Serbia është duke e shfrytëzuar këtë mungesë të kohezionit politik, pasi edhe vetë BE-ja nuk e ka artikuluar qartë qëndrimin se procesi

duhet ta sjellë njohjen reciproke. "Meqë nuk dihet se cili është epilogu dhe pozicionimi i Kosovës, duket se Serbia po shfrytëzon këtë çështje, duke vënë fajin te Kosova si penguese e dialogut. Kosova duhet ta bëjë të qartë se është për dialog, por jo me kushtin që të priset sistemi unitar i Republikës dhe që të dalë si shtet jofunksional", ka thënë Krasniqi.

Përfaqësuesi i posaçëm i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, në vizitat e fundit në Prishtinë e Beograd (13-15 tetor) nuk i është referuar "bllokimit të dialogut", por ka kërkuar nga të dyja palët që t'u përmbahen zotimeve. Lajçaku ka kërkuar nga Kosova që ta zbatojë marrëveshjen për asociacionin e komunave me shumicë serbe. Për këtë temë, Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje fillimisht më 2013, në kuadër të Marrëveshjes së parë të Brukselit.

Po më 2015 palët nënshkruan marrëveshje shtesë për parimet e themelimit të asociacionit. Por, Gjykata Kushtetuese e Kosovës konstatoi se parimet nuk janë në harmoni me

Kushtetutën e Kosovës. Ndërkohë, më herët Grupi Ndërkombëtar i Krizave në raportin e fundit vjeshtor kishte sugjeruar që Bashkimi Evropian ta shikojë mundësinë që në platformën dialoguese Kosovë - Serbi, të përcaktojë se marrëveshja finale duhet ta përfshijë njohjen e ndërsjellë. Kjo organizatë e pavarur, që analizon konfliktet në botë, megjithatë ka parashikuar se zgjidhja finale do të përfshijë koncesione të mëdha, duke përfshirë autonomi të gjerë për komunat serbe apo shkëmbim të territoreve. Një nga hartuesit e këtij raporti, Giuseppe Fama, udhëheqës i Çështjeve Evropiane në këtë organizatë, në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" pati theksuar se BE-ja nuk duhet të imponojë kufizime në dialog dhe se Shtetet e Bashkuara duhet të kenë rol në bindjen e Kosovës që ta ridizajnojë platformën dialoguese. Sipas tij, nëse Kosova pajtohet për autonomi të gjerë për komunat me shumicë serbe, e njëjta duhet të vlejë edhe për Luginën e Preshevës në Serbi.

Trumpi në fushatë: Për marrëveshjen Kosovë - Serbi më nominuan për Nobel

NEW HAMPSHIRE, 26 TETOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump, gjatë tubimit të djeshëm në New Hampshire, ka folur sërish për marrëveshjen e Uashingtonit në mes të Kosovës dhe Serbisë, e cila është nënshkruar më 4 shtator. Trumpi ka thënë se për këtë marrëveshje dhe për çështje të tjera të politikës së jashtme, atij ia kanë dhënë çmimin Nobel. Ai

pastaj e ka përmirësuar gabimin duke thënë se me "çmimin Nobel" mendon nominimin për Nobel. "Me Serbinë e Kosovën ne kemi arritur marrëveshje dhe më kanë dhënë çmimin Nobel për këtë, më dhanë Nobel edhe për diçka tjetër, duhet të më japin çmim Nobel edhe për atë që kam bërë në Siri. Me atë që them çmimin Nobel e kam kuptimin e nominimit", ka thënë Trumpi gjatë fjalimit.



Blokojen xhirollogaritë e Telekomit

PRISHTINË, 26 TETOR - Të hënën janë bllokuar xhirollogaritë e Telekomit të Kosovës si pasojë e borxhit ndaj "Z-Mobile". Lajmin e ka konfirmuar kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Telekomit, Lamih Balaj. "Llogaritë janë

bllokuar. Kjo është bërë me kërkesë të kompanisë 'Z-Mobile' si pasojë e borxhit", ka thënë Balaj. Po ashtu, xhirollogaritë e Telekomit ishin bllokuar, pasi kjo e fundit e ka humbur një rast në arbitrazh nga "Z-Mobile".

Përmbauesit kanë bllokuar llogaritë, duke kërkuar shlyerjen e borxhit të përmbaimit. Po ashtu, Gjykata e Apelit e ka vërtetuar vendimin e Gjykatës Themelore Prishtinë dhe ia ka njohur të drejtën kompanisë

"Dardafone.net LLC" për përmbaimit e borxhit milionësh nga Telekomit i Kosovës. Duke iu referuar provave, Apeli e ka konsideruar të ligjshëm përmbaimit e 25 milionë eurove nga Telekomit.



Covidit pritet të 'fshijë' 8 miliardë euro nga ekonomia shqiptare për tri vjet

TIRANË, 26 TETOR - Sa më shumë kalojnë muajt, aq më të qarta bëhen pasojat që ajo solli në ekonomi infeksioni i padukshëm i Covid-19 dhe po aq më e pasigurt bëhet edhe e ardhmja. Vetëm një gjë është e sigurt, që ekonomia nuk do të jetë më si më parë dhe ditët e "arta" të një aktiviteti normal dhe jetese të shkujdesur kanë marrë fund, të paktën për një periudhë afatmesme. Të gjitha pritshmëritë për ecurinë ekonomike, jo vetëm në Shqipëri, por në mbarë botën janë zhvlerësuar. Humbjet në vend, në raport me vitin e mëparshëm, por dhe në krahasim me rritjen që do të kishte pasur vendi nëse nuk do të ishte përballur me koronavirusit janë tepër të larta. Sipas parashikimeve të Ministrisë së Financave, përpara se të fillonte kriza e Covid-19, prodhimi i brendshëm bruto (PBB-vlera e mallrave dhe shërbimeve përfundimtare të krijuara nga ekonomia gjatë një periudhe kohe të caktuar) pritej që të arrinte në 2.4 trilionë lekë, pse gati 19 miliardë euro në vitin 2022. Financat prisnin mesatarisht një rritje ekonomike prej rreth 4 për

qind në vit. Por, në relacionin e projektbuxhetit 2021, pritshmëritë për PBB-në në vitin 2022 tashmë janë zhvlerësuar në 14.5 miliardë euro. Në vetëm tre vjet, 2020-2022, Covid-19 pritet të fshijë rreth 1 trilionë lekë, ose 8 miliardë euro të ardhura potenciale, që do të ishin krijuar nëse do të kishim pasur ecuri normale të ekonomisë (diferenca midis PBB-së së projektuar para krizës dhe pas krizës, përkatësisht për secilin vit). Për vitin 2020, kur vlerësohet të ketë qenë kulmi i efekteve të Covid-19, ekonomia shqiptare pritet të tkurret nga -6.4 për qind, sipas parashikimeve të qeverisë shqiptare, deri në -9 për qind (nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim). Fondi Monetar Ndërkombëtar pret që tkurrja të jetë -7.5 për qind dhe banka Botërore në -8.4 për qind. Cilado që të jetë rënie, kjo do të jetë tkurrja më e madhe e ekonomisë që nga viti 1997, kur vendi ra me më shumë sesa 10 për qind. Për vitin 2021, gjithnjë nëse nuk do të ketë mbyllje tjetër drastike, ekonomia pritet të rikuperohet me ngadalë, me



rritje prej rreth 5-5.5 për qind, sipas pritshmërive të qeverisë dhe institucioneve ndërkombëtare. Sipas të gjitha gjasave, si rrjedhojë e rënies së fortë këtë vit dhe rikuperimit të ngadaltë vitin e ardhshëm, ekonomia pritet që të arrijë nivelin e para krizës (2019-s) vetëm në 2022-in. Tkurrja e ekonomisë pritet që të ulë dhe të ardhurat për frymë, të cilat sipas parashikimeve të projektbuxhetit pritet të bien me 6 për qind në 2020-n, (nga 586 400 lekë në 550 400 lekë)

ose 36 mijë lekë (290 euro) më pak. FMN-ja është edhe më pesimiste. Sipas saj të ardhurat për frymë të shqiptarëve në 2020 pritet të ulen me 425 dollarë, ose me gati 8 për qind në krahasim me vitin e mëparshëm. Në rajon, Shqipëria (-425 USD) dhe Mali i Zi (-892 USD) pritet të kenë rënien më të lartë të të ardhurave për frymë, për shkak të tkurrjes më të lartë ekonomike të parashikuar për këto vende, që janë të lidhura me turizmin. Për

maqedonasit, humbja do të jetë minimale (90 dollarë më pak) dhe për boshnjakët arrin në -253 dollarë për frymë më pak. Për shtetasit e Kosovës, humbja është -287 dollarë për frymë, me një rënie prej 6.5 për qind. Në rajon, shteti që ka qenë më rezistent ndaj krizës së Covid-19 është Serbia. Ky i fundit është ndër të paktët në botë, ku FMN parashikon që të ardhurat për frymë nuk do të bien, përkundrazi do të rriten lehtë, me 90 dollarë.

/Monitor/

Ahmet Shala mohon të jenë djegur dokumentet në AKM

PRISHTINË, 26 TETOR - Ish-zëvendësudrejtori menaxhues në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), Ahmet Shala, ka mohuar se në këtë institucion gjatë vitit 2008 janë djegur disa dokumente. Ai ka thënë se të gjitha dokumentet janë të ruajtura në serverët e Bashkimit Evropian. Këto deklarata Shala i ka bërë gjatë raportimit në Komisionin Hetimor Parlamentar në lidhje me procesin e privatizimit. Shala ka thënë se të gjithë të punësuarit në AKM, tash Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), kanë qenë të financuar nga BE-ja. "AKP-ja do të duhej të kërkonte nga Bashkimi Evropian qasje në serverët ku janë të gjitha



dokumentacionet. Nuk besoj se të dhënat janë shkatërruar", ka thënë ai.

Më tutje, ai ka bërë me dije se procesi i privatizimit në Kosovë ka qenë transparent por, sipas

tij, nuk ka arritur objektivat e zhvillimit ekonomik. "Procesi i zgjedhjes ka qenë konkurs i

hapur dhe kam pasur nderin që jam zgjedhur unë. Të gjithë të punësuarit që kemi qenë në AKM kanë qenë të financuar nga BE-ja. Unë jam kualifikuar dhe kam punuar edhe si staf ndërkombëtar. Kualifikimi im ka qenë më i lartë se i disa ndërkombëtarëve dhe jam kualifikuar. Dhe pse ta dëmtoj pagën e Kosovës. Ka qenë pagë ndërkombëtare. Të gjitha proceset e privatizimit janë kritikuar. Në rrethanat që ka ekzistuar Kosova në atë kohë, modeli i përzgjedhjes u është përshtatur kushteve dhe, si i tillë, nuk ka arritur objektivat e zhvillimit ekonomik dhe si proces ka qenë më transparent", është shprehur Shala.

Veriu i Kosovës, pa kuponë fiskalë

Bizneset në komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës operojnë pa kuponë fiskalë. Në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) janë të regjistruara vetëm 981 biznese me gjithsej 1 316 njësi aktive. Nga ky numër, tatim në ATK paguajnë vetëm 255 biznese. Nga muaji janar deri në muajin shtator të këtij viti vlera e tatimeve të marra nga këto biznese, pa kontribute pensionale, është 663 mijë euro



PRISHTINË, 26 TETOR - Biznese të profileve të ndryshme operojnë në katër komunat e banuara me shumicë serbe në pjesën veriore të Kosovës (Mitrovicë e Veriut, Zvečan, Zubin Potok dhe Leposaviq), por në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) janë të regjistruara vetëm 981 biznese me gjithsej 1 316 njësi aktive. Nga ky numër, tatim në ATK paguajnë vetëm 255 biznese. Nga muaji janar deri në muajin shtator të këtij viti, vlera e tatimeve të marra nga këto biznese, pa kontribute pensionale, është 663 mijë euro, kanë thënë zyrtarë të administratës. Tatimet janë burimi kryesor i mbledhjes së të hyrave publike me të cilat shteti i plotëson të dalat publike. Por, shifrat për regjistrimin e bizneseve ndryshojnë nga ato të ATK-së. Në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK), agjenci kjo që funksionon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, thuhet se në pjesën veriore të Kosovës janë të regjistruara 3 740 biznese. Në Mitrovicën e Veriut janë të regjistruara 720 biznese. Sipas ATK-së, këto biznese mund të jenë të regjistruara, por nuk janë aktive. Po ashtu, një numër i

bizneseve mund të mos kenë përfunduar procedurat zyrtare për çregjistrim në ARBK. "Radio Evropa e Lirë" ka vizituar disa nga bizneset aktive në pjesën veriore të Kosovës, pronarët e të cilave nuk kanë dashur të prononcohen para mikrofonit. Megjithatë, ata thonë se rregullisht paguajnë obligimet tatimore në Administratën Tatimore të Kosovës. Sipas tyre, pagesat realizohen në bazë të strukturës së biznesit të regjistruar, qoftë ndërmarrje e vogël, e mesme apo e madhe. Ndryshe nga deklarimet, situata në terren është krejt ndryshe. Bizneset në këtë pjesë nuk janë të pajisura me Pajisje Elektronike Fiskale, në bazë të të cilave pas çdo blerje lëshohet kuponi fiskal. Njëherësh janë të obliguar ta bëjnë transmetimin e raporteve periodike në Administratën Tatimore të Kosovës. Madje një nga pronarët në veri thotë se "nuk lëshon kupon fiskal si të tjerët, por që ai rregullisht paguan detyrimet tatimore bazuar në qarkullimin si dhe taksat mbi pagat për punonjësit, të cilat përfshijnë taksat dhe kontributet e sigurimeve pensionale". Procesi i vendosjes së arkave fiskale në Kosovë ka filluar në

vitin 2009, dhe qëllimi nga Administrata Tatimore e Kosovës ishte evitimi i evazionit fiskal, pasi potenciali i këtij sistemi është që t'i regjistrojë të gjitha hyrjet dhe shitjet në një dyqan. Por, zyrtarë të ATK-së nuk kanë dhënë ndonjë përgjigje se sa është numri i bizneseve të pajisura me pajisje fiskale. Moslëshimi i kuponit fiskal dhe mostransmetimi i të dhënave në Administratën Tatimore të Kosovës janë të ndëshkueshme me ligjet në fuqi. Zyrtarë të Administratës Tatimore të Kosovës kanë pohuar se qasja e këtij institucioni në katër komunat e banuara me shumicë serbe nuk është shumë komode nëse krahasohet me rajonet e tjera të Kosovës.

Valentina Bytyqi, zëdhënëse në ATK, në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë" thotë se në atë pjesë ka inspektorë të

komunitetit serb të cilët janë të autorizuar të kryejnë aktivitete, inspektime dhe vëzhgime. Dhe përkundër vështirësive, ka thënë ajo, është arritur që të kryhen aktivitete dhe të ketë të hyra prej bizneseve të asaj pjese. Shmangia e lëshimit të kuponëve fiskalë u mundëson bizneseve që t'u ikin obligimeve tatimore, duke krijuar evazion fiskal, krim të organizuar dhe dëmtim të buxhetit të Kosovës, ka thënë Rrustem Abiti, ish-koordinatori i Zyrës Rajonale në Mitrovicë në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës. Ai në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" është shprehur se bizneset në pjesën veriore të Kosovës nuk i japin llogari shtetit të Kosovës. Në këtë pjesë është e argumentuar shmangia nga pagesa e tatimit, që më pas krijon evazion fiskal. Kurse shteti i Kosovës ka neglizhuar këtë problem, pasi nga

shmangia e tatimeve buxheti i Kosovës humbet miliona euro. "Shteti nuk ka vepruar si duhet në këtë çështje, sepse aty ku është policia duhet të jetë edhe inspektori tatimor, inspektori doganor dhe të gjitha. Po e them këtë, pasi Policia e Kosovës vepron në veri, patjetër është dashur që të shoqërohen këto institucione që t'i mbledhin tatimet e obliguara", ka thënë Abiti. Por, Valentina Bytyqi ka thënë se ATK-ja ka pasur aktivitete edhe në pjesën veriore, por jo aq sa duhet dhe aq sa ka nevojë implementimi i ligjit edhe në atë pjesë, kjo për shkaqe të sigurisë. Mirëpo, në të shumtën e rasteve gjatë aktiviteteve, ka thënë ajo, ka pasur mbështetje nga Policia e Kosovës.

Që nga paslufta Prishtina zyrtare nuk ka arritur ta shtrijë në tërësi autoritetin shtetëror në pjesën veriore të Kosovës.

'IuteCredit' e dërgon në arbitrazh shtetin e Kosovës

Institucioni mikrofinanciar "IuteCredit" e ka dërguar në arbitrazh shtetin e Kosovës. Këtë e ka bërë me dije ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, i cili ka thënë se dikasteri të cilin ai e drejton do t'i ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm ligjor lidhur me këtë çështje. "Avokati i Shtetit kërkon që sa më shpejt të merret vendimi për procedurat në mënyrë që afatet ligjore të Tribunalit të mos na ndëshkojnë. Askush nuk mund të përfitojë duke dëmtuar qytetarët, por as duke shkelur ligjin që është në fuqi", ka shkruar Selimi në llogarinë e vet në "Facebook". Muaj më parë Banka Qendrore e Kosovës ka marrë vendim që të mbyllë dy institucione

mikrofinanciare, ndër to "IuteCredit". Guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti, pati treguar sesi "Iute Credit" dhe "Monego" kanë shfrytëzuar kushtet e vështira financiare të kosovarëve, duke aplikuar kredi të shpejta me norma të pabesueshme të interesit. Veprimtaria e tyre në këtë formë ka vazhduar deri tash, përkundër gjobave të shqiptuara dhe urdhrat të dhënë nga BQK-ja. Ka pasur raste kur norma e interesit ka shkuar deri në 1 000 për qind. Sipas vlerësimit të guvernatorit, veprimtaria e këtyre dy institucione mikrofinanciare ka rrezikuar stabilitetin financiar në Kosovë.





GANIMET KLAIQI (1965-2017)
(in memoriam)

Titujt në gazetatat e Kosovës

Titujt nga gjuhëtarët vlerësohen si pjesët më të vështira të teksteve në zejen e gazetarisë. Në njërin anë përmbajnë pjesën thelbësore të artikullit, kurse në aspektin global duhet ta shpërfaqin informacionin më të rëndësishëm. Së këndejmi, ata e fitojnë ose e humbin lexuesin, konkretisht marrësin e informacionit. Në rast se janë të paqartë, lexuesit nuk i zgjohet kureshtja për të hyrë në tekst. Hyrja në tekst bëhet nga qartësimi i shprehjeve gjuhësore. Nga kjo bazë titujt i plotësojnë detyrat formale dhe funksionale të artikujve.

Titulli, nëntitulli, koka e lajmit, si njësi konvencionale që janë, njihen nga shfrytëzuesit e tyre në çdo kulturë dhe grup të caktuar etnik.¹ Nga kjo pikëpamje, titujt përfaqësojnë formë të posaçme të prezentit të gazetarisë. Në një përkufizim stilistik të studiuesit Lucke, që e kishte bërë në vitin 1963, titujt duhet të jenë të shndritshëm, të formuluar, të shkurtër, të hetueshëm, të kërkueshëm, rastësorë, të gdhendur dhe përmbajtjesorë.² Në kuptimin e formulimit të tyre, sipas studiuesve të gjuhës së gazetave, titujt nxjerrin dallime midis gjuhës praktike dhe asaj pragmatike. Dallimi bëhet në kriteret e sistemit gjuhësor, para së gjithash, sintaksor. Një përkufizim përmbajtjesor për këtë e ka dhënë studiuesja

Barbara Sandig, sipas së cilës, titujt janë mbishkrime që dëshmojnë vlerën e fjalisë.³ Nga ky këndvështrim titujt në disa gazeta të përditshme të Kosovës, si *Përkujdesje që obligon (Rilindja)*, *Tjera ndryshime (Epoka e re)*, *Takime lobuese (Lajm)*, *Presidenti i partive (Infopress)* nuk paraqesin karakter të plotë komunikimi ose, thënë ndryshe, krijojnë asociim. Nga pikëpamja e kësaj studiueseje, titujt e këtillë janë shembuj të këqij dhe pa shkallë të mjaftueshme të njoftueshmërisë. Të tillët paraqesin indiferencë për aktualitetin.

Titulli është një mbishkrim, i cili përsërit ose parafrazon shprehje nga konteksti.⁴ Sipas studiuesve, vendosja e titujve në gazeta duhet të përcaktohet me karakteristika gramatikore, sintaksore dhe stilistike. Pa këto elemente komplikimi i titujve në raport me thjeshtësinë mund të ndikojë në procesin e interpretimit. Nga ana tjetër, titujt me shprehje të fuqishme gjuhësore, të përzegjedhura mirë, zgjojnë interesimin e marrësit. Titujt e kësaj natyre bëhen më të kërkueshëm nga lexuesit, të cilët, kur i shfletojnë gazetatat, duan t'i gjejnë të tillët. Nëse titujt zgjojnë interesim te lexuesi, kjo është bërë për shkak të dinamikës së shprehjeve gjuhësore, por që s'është demaskuar gjithçka nga

përmbajtja e artikullit. Një titull i mirë mbulon informacionet thelbësore dhe konkretizon temën e artikullit. Megjithëkëtë, pritjet e këtilla nuk mund të harmonizohen gjithmonë për t'u kapur aspektet: titulli dhe teksti në artikullin e gazetës.

Karakteristikë tjetër, sipas studiuesve të titujve, në aspektin gjuhësor është se nuk është e thjeshtë të vendoset se cilët tituj janë më të vlefshëm, cilët janë më informativë dhe më të dukshëm për të zgjuar interesim. Nga pikëpamja pragmatike e gjuhës, titujt kanë për detyrë të transmetojnë informacion të përmbledhur me fakte të besueshme për ta nxitur dhe motivuar lexuesin. Studiuesi i gjuhës së gazetave në Kosovë, Bardh Rugova, në studimin për këtë çështje thekson se në gazetatat e Kosovës rëndom, krahas titullit dhe nëntitullit, shënohet edhe mbititulli... koncepti mbititull zakonisht shënon rrethanat e caktuara, titulli shënon temën dhe nëntitulli përmbledhjen, duke lënë mundësi që kjo përmbledhje të zgjerohet edhe në kreun e shkrimit.⁵ Nga kjo që u theksua, titujt rezultojnë të jenë pjesa më e rëndësishme objektive e artikullit si në kriterin formal, po ashtu edhe në atë përmbajtjesor. Studiuesi Rugova, pasi thekson se titulli i shkrimit ka një formë të caktuar gjithnjë, sepse vendoset në fillim, ende pa nisur shkrimi,

konstaton se titulli ka një funksion të rëndësishëm tematik, ngaqë i shpreh temën dhe përmbledhjen e ngjarjes kryesore të shkrimit, asaj që ka prioritet gjatë të kumtuarit.⁶

Nga pikëpamja e studiuesit Herald Burger, titujt paraqesin pozitën dhe formulimin e pavarësisë relative të një gazete. Funksionimi i tyre në radhë të parë u adresohet lexuesve.⁷ Ndërtëkstualitetin e parë të titujve e lidh me mbititullin, nëntitullin dhe hyrjen. Fillimi i tekstit në kuptimin e funksionit paraqet rëndësi sa edhe vetë titulli sepse me pak fjalë paraqet përmbajtjen e artikullit me rrjedhshmëri. Me fjalë të tjera, sipas tij, titulli në gazetarinë moderne formohet në bazë të tekstit.⁸ Nga sa u theksua, përshtypja e parë për lexuesit zakonisht krijohet nëpërmjet titujve, të cilët, në fakt, janë karrem për ta tërhequr lexuesin për ta vazhduar leximin e një artikulli gazetaresk deri në fund. Titulli ka rëndësi esenciale, duke u nisur nga fakti se njeriu si qenie është i prirë që përshtypjen e parë ta krijojë pikërisht nga ajo që e sheh së pari. Në parim, lexuesi së pari e përqendron vëmendjen në titull, ndaj edhe gjithçka nis aty. Ideja e gazetarit, apo e redaktorit është të vendosë një titull të bazuar në tekst dhe i cili, përveç kësaj, është formuluar në atë mënyrë sa ta tërheqë lexuesin.

Janë tri arsye të cilat e determinojnë rëndësinë e titujve në kuadër të një gazete. Titujt kanë, së pari, karakter informativ për një temë, çështje apo përmbajtje. Nuk duhet të kenë qëndrim, pra të mos shfaqet mendimi i gazetarit apo redaktorit, por të jetë si një emërues i përbashkët i një situatë për të cilën është ndërtuar artikulli. Titulli si njësi sinjalizon një pjesë të informacioneve të tekstit.⁹ P. sh., nëse trajtohet çështja e imunitetit të deputetëve të Kuvendit të Kosovës si dhe të zyrtarëve të lartë të këtij shteti të ri dhe Gjykata Kushtetuese jep vlerësimin gëzojnë apo jo imunitet, atëherë titulli mund të nxirret nga konteksti, nëpërmjet të cilit do të përshkruhet një situatë e tërë, por gjithnjë duke mbajtur distancë ndërmjet autorit dhe çështjes. P. sh., në ballinë të së përditshmes *Koha ditore* titulli *Kushtetuesja përmend arrestimin për deputetët, jo për qeveritarët* vërehet se është ndërtuar distancë e dukshme ndërmjet autorit të tekstit dhe situatës. Kjo distancë pikësëpari është rezultat i përdorimit të foljes në kohën e tashme të dëftores dhe të kryefjalës në vetën e tretë të njëjësit. Në këtë titull, me pak fjalë të ngjeshura, thuhet shumëçka, ndërsa lexuesit i mbetet për të "hulumtuar" më tepër brenda tekstit. Edhe titulli

tjetër në të njëjtën gazetë, në të njëjtën ditë, si: *AAK: Politikat e ministrit Agani për shëndetësinë, të dështuara*, ka distancën e mjaftueshme midis dërguesit dhe marrësit. Edhe në këtë titull, gazetari, nëpërmjet shprehjeve gjuhësore dhe ngjeshjes sintaksore të fjalëve, ka arritur ta krijojë distancën me ngjarjen a fenomenin, sepse nuk është qëndrim i gazetarit apo redaktorit t'i përcaktojë nëse janë apo jo të dështuara politikat e ministrit Agani. Ata i referohen një subjekti, një ministri, duke e vendosur edhe titullin mbi atë bazë. Në aspektin e gazetarisë titulli i gazetës ka për qëllim ta informojë opinionin e gjerë se çfarë po ndodh, kurse në aspektin gjuhësor ai ka rëndësi për ta bërë sa më të qartë raportin dërgues - marrës. Ndryshe janë shprehjet gjuhësore të vendosura në një titull, si: *I prishi paraja*, në gazetën e përditshme *Epoka e re*. Këtu gazetari merr qëndrim dhe ka vlerësim për fenomenin. Këta tituj që shpesh përdoren për stil paraqesin subjektivizëm dhe, pos të tjerash, dalin të jenë të mangët edhe në gjymtyrë, pasi nuk jepet të nënkuptohet se kush janë ata që në të vërtetë i ka prishur paraja, që do të thotë se vetvetiu mungon pyetja, për të marrë një përgjigje të këtyllë. I njëjti titull dhe në të njëjtën ditë, për shembull në *Koha ditore*, është: *Paratë ndajnë Lëvizjen për Bashkim me 'Vetëvendosjen'*, në të përditshmen *Zëri: Parja ndan dy lëvizjet*, në *Lajm: LB dhe VV shkurorezohen sherri i parave*.

Titujt përdoren edhe për

çështje estetike. Preferohet vendosja e titujve të shkurtër, përmbledhës sepse humbet ritmi dhe esenca për të cilën vendosen. Struktura e titujve, sipas Heraldit, duhet të jetë e qartë, të ketë kompaktësi, duke i përdorur drejt mjetet gjuhësore, siç janë foljet dhe mjetet e tjera sintaksore e stilistike. Ata formulojnë hyrjen tematike në tekst, derisa nëntitujt specifikojnë faktet për ngjarjet. Këto elemente bashkërisht formulojnë logjikën ndërtekstuale, me mjete gjuhësore që japin kompleksivitetin e titullit, duke e lidhur atë me hyrjen dhe rrjedhën e tekstit.¹⁰ Zakonisht parapëlqehen titujt që s'e kalojnë një rresht në proporcion me shkrimin. Por, në disa media të Kosovës ka edhe titujt të karakterit sensacional, por edhe me nga dy rreshta. Në fakt, *Koha ditore* ka aplikuar modelin e ndërmjetëm, i cili konsiston në vendosjen e titujve që përkohet me tekstin, që kanë dalë rrjedhimisht nga teksti dhe që kanë bazë në të. Titujt nuk janë njëtrajtësisht rezyme e përmbajtjes, por pjesë e saj, në të cilën më i rëndësishëm është prezantimi i fakteve përpara rrëfimit. Në parim, te titujt gazetareskë nuk ka dilemë se synim kryesor është që ata të jenë përmbajtjesorë, tërheqës dhe të shkurtër, gjithnjë duke i pasur parasysh mjetet gjuhësore dhe lidhjen e ngjeshur sintaksore. Pra, titulli është një përmbledhje e tekstit, i cili përmban në vete faktet kryesore. Shpesh titujt i ngjasojnë një lajmi flash si, p. sh.: *Shkarkohet presidenti*.

Për të njëjtën çështje gazetat e Kosovës të datës 21 shtator 2011 japin versione të ndryshme të titujve:

Koha ditore: Kushtetuesja përmend arrestimin për deputet, jo për qeveritarët;
Zëri: Kushtetuesja foli: S'ka imunitet;

Lajm: Pa imunitet;
Epoka e re: Deputetët, presidenti dhe anëtarët e qeverisë nuk gëzojnë imunitet;
Kosova sot: Mund të arrestohen;

Infopress: Vendim antikushtetues.

Nga tetë gazeta të përditshme që botohen në Kosovë, për të njëjtën çështje titujt dalin me shprehje të ndryshme, në kuptimin e përdorimit të shenjave gjuhësore. Nëse njoftueshmëria është një nga shtatë kriteret e tekstualitetit, qëllimi i të cilit e jep të pritshmen dhe të papritshmen, disa nga këta tituj janë me mangësi. Një përzgjedhje e mirë e fjalëve e bën informacionin më të dëshirueshëm, kurse dhënësin e informacionit shumë më të qëndrueshëm e më të besuar. Nëpërmjet titujve lexuesi i pranon edhe artikujt, pasi që ata e sforcjnë edhe njoftueshmërinë e tij. Kjo ka kuptim për faktin se është nxjerrë pika kryesore e artikullit. Kjo, sipas studiuesit Rugova, do të thotë se përzgjedhja e një titulli të mirë e popullarizon gazetën. Ai thekson se në këtë pikë ka rëndësi të madhe kombinimi i fjalëve në një strukturë të shkurtër të fjalisë, ku rolin kryesor e merr subjekti, veprimi i të cilit mund të përmbledhet në pak fjalë, kurse të shtjellohet në tekst. Me një fjalë, titulli i

gazetës paraqet hapin më të mirë që të nxitet lexuesi për të hyrë në tekst dhe për të bashkëjetuar me të. Rugova i vlerëson të gabueshëm titujt në gazetën e Kosovës, kur ata i nxjerrin si tituj asociativë. Kjo e dëmton në shkallë mjaft të madhe informacionin dhe kalon në suaza të tekstit letrar. Por, në gazetën e përditshme, në të shumtën e herëve, titujt e gazetave dalin të njëtrajtshëm, sepse gazetarët apo redaktorët formulimin e titujve e pronësojnë, duke mos dashur të dalin nga shabllonet.

Që njoftueshmëria e tekstit të ketë edhe qytetari, gazetarët dhe redaktorët e vëmendshëm rëndom i përzgjedhin titujt që të mos jenë emocionalë, të mos kenë egërsi dhe të jenë plotësisht informativë. Kjo praktikë duket të jetë shumë e pranishtme në të përditshmen e pavarur informative *Koha ditore*, derisa në disa të tjera mungon. Dëshmi për këtë është rasti i burgosjes së gjashtë zyrtarëve komunalë të Prishtinës. Për dallim nga *Koha ditore* (4 maj 2011), kur ka dhënë informacionin se *Policia kundër krimeve ekonomike ka arrestuar 6 zyrtarë komunalë*, në disa gazeta të tjera informacioni është dhënë: *Gjashtë në kajmak* (*Express*, 4 maj 2011). Sado që titulli i fundit duket si bombë, ai është tendencioz dhe i njëanshëm. Një titull i tillë e mbyl informacionin dhe tekstin gazetaresk e kthen në një tekst krejt letrar, duke i sjell vështirësi lexuesit që ta pranojë në hapin e parë lajmin. Pra, është titull subjektiv.

Një titull për lexuesin është

potencial atëherë kur ai e pranon atë në shikim të parë. Kurse nëse vetë gazetari dyshon se titulli i tij nuk ka arritur të përmbledhet me shprehjet më të pranueshme gjuhësore, atëherë edhe lexuesi do ta ketë po atë dilemë. Një titull i mirë dhe informativ në asnjë rast nuk bën të jetë si një pjesë e një deklaratë të ashpër, aq më tepër kur brenda tij mund të shtrohen shumë pyetje për të marrë një përgjigje. Prova më e pranueshme e një titulli është akceptimi i tij informativ. Dëshira superlative e autorit për të bërë sa më shumë bujë titulli i tij e bën atë që të ngatërrohet në përmbajtje të tekstit dhe kalon në paqëndrueshmëri.

I doli duqi (*Infopres*) ishte një titull në një gazetë të Kosovës, një ditë pas arrestimit të gjashtë zyrtarëve të Komunës së Prishtinës. Gazetari, apo redaktori, kanë synuar të jenë superlativë, por në aspektin pragmatik e informativ të gazetës i ka kaluar të gjitha caqet. Në këtë aspekt një gazetari i mirë dhe që synon njoftueshmërinë për ngjarjet që na rrethojnë për çdo ditë do të duhej ta peshonte vënien e fjalëve së pari në titull e pastaj edhe në tekst. Sa më e madhe që të jetë pasuria e leksikut, aq më e madhe është edhe mundësia e përzgjedhjes së një titulli më të shkurtër dhe më domethënës, në kuptimin e përmbledhjes së informacionit. Janë pikërisht këto elemente të trajtuara me shkallë të njoftueshmërisë nga studiuesit Beaugrande dhe Dressler dhe të pasuar edhe nga studiues të tjerë. Ata pasi e kanë cilësuar njoftueshmërinë si kriterin e pestë të tekstualitetit, kanë caktuar tri shkallë të cilat kategorizojnë marrëdhëniet dërgues - marrës.

(Marrë nga revista "Akademia")

1 Van Dijk, i cituar nga Bardh Rugova, *Gjuha e gazetave*, f. 116

2 Hartmut Luck, *Zeitungsd Deutsch und Umgangssprache. Untersuchungen zur des Spiegels*. In: *Muttersprache*, Munchen, 1963, f. 335

3 Barbara Sandig, *Syntaktische Typologie der Schlegzeile. Möglichkeiten und Grenzen der Sprachökonomie im Zeitungsd Deutsch*. Munchen: Institut für Germanistik, (Linguistische Reihe 6), 1971, f. 38

4 Hellwig Valentin, *Zeitgeschichte 1818-2004*. Klagenfurt, 2005, f. 170

5 Bardh Rugova, *Gjuha e gazetave, Koha*, Prishtinë, 2009, f. 118

6 Po aty f. 110

7 Herald Burger, *Mediesprache: Eine Einführung in Sprache und kommunikations formen der Massmedien*, Verlag 3, Berlin, 2005, f. 114

8 Po aty f. 115

9 Bardh Rugova, *Gjuha e gazetave, Koha*, Prishtinë, 2009, f. 118

10 Herald Burger, *Mediesprache: eine Einführung in Sprache und kommunikations formen der Massmedien*, Verlag 3, Berlin, 2005, f. 116

Ganimet Klaiqi (1965-2017) u lind në Poliçkë të Komunës së Dardanës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Dardanë, Fakultetin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Prishtinë, edhe studimet master për gjuhë shqipe po në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina". Në vitin shkollor 1993/1994 ka punuar arsimtar i gjuhës dhe letërsisë shqipe. Një kohë ka qenë korrespondent i gazetës "Koha ditore", kurse gjashtë vjet të tjera punë i ka bërë në redaksinë e saj në Prishtinë (2003-2009). Klaiqi është shpërblyer nga BE-ja me çmim për gazetari hulumtuese. Vitet e fundit Klaiqi punonte në Universitetin për Biznes dhe Teknologji. Ndërroi jetë më 15 maj 2017 në Prishtinë. Ka lënë pas gruan dhe tre fëmijë.



Titujt njoftues të gazetës *Rilindja*, të *Kohës ditore*, të *Zërit*, të *Expressit*, të *Epokës së re*, të *Kosovës sot*, të *Lajmit*, të *Infopressit*, në një periudhë kohe të caktuar, përbëjnë objektivin e këtij libri studimor. Ata që punojnë në medie dhe që kanë pasur në duar libër teorik nga gjuha e gazetarisë, të cilin do teoricien të huaj, lehtë do ta kuptojnë këtë libër teorik dhe praktik të Ganimet Klaiqit, mbushur me shembuj të titujve të medieve të shtypura të Kosovës, disa prej të cilave botohen edhe sot, disa prej të cilave botoheshin dikur. Kështu që, nëse në ndonjërin nga këto gazeta, deri para pesë vjetësh, keni qenë gazetar, kryeredaktor, redaktor, lektor, keni shkruar dhe shkruar tituj dhe jeni mburrur për stilist, një vlerësim për punën tuaj, për titujt e teksteve të shkurtër dhe të gjatë, të shkruar me dhe pa vend, drejt dhe me shkelje të normës gjuhësore, e gjeni këtu, mbështetur në fakte dhe në literaturë, kryesisht gjermane.

Sh. B. Armagedoni

ISBN 978-9951-697-62-0

4.99 €

Ganimet Klaiqi

NJOFTUESHMËRIA NË TITUJT E GAZETAVE

NJOFTUESHMËRIA NË TITUJT E GAZETAVE



















Në Gjilan mbahet koncerti 'Ti nuk je vetëm'

GJILAN, 26 TETOR (ER) - Nën organizimin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, në Gjilan është mbajtur koncerti "Ti nuk je vetëm", si ndërgjegjësim për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit. Me masa anti-Covid, në sallën e teatrit të qytetit kanë marrë pjesë personalitete të rëndësishme të jetës politike, të fushës së mjekësisë, kulturës dhe qytetarë të rëndomtë. Të pranishmit kanë parë performancën fantastike të sopranos së Teatrit të Operës së Tiranës, Eva Golemi, të shoqëruar nga Genita Hoxha, piano dhe Mario Guralumi,

violinçelo.

Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Deniza Limani, pasi ka falënderuar kryetarin e Gjilanit, Lutfi Haziri, për mbështetjen e ofruar në kalendarin e aktiviteteve për nder të muajit tetori rozë, ka thënë ky është kulmim i aktiviteteve në kuadër të shënimit të muajit rozë, duke shpresuar se sadopak kanë ndikuar në ndërgjegjësim për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit.

Fushata "Ti nuk je vetëm" përmbyllet më 30 tetor, me një ligjëratë këshilluese, e cila jepet online me fillim në orën 17:00.



Vazhdojnë punimet për muzeun e dëshmorëve në Landovicë



PRIZREN, 26 TETOR (ER) - Drejtorja e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik (DTZHE) në Prizren ka njoftuar se punimet për restaurimin e Kompleksit Memorial të

Dëshmorëve në Landovicë janë duke vazhduar me ritëm të përshpejtuar. Aktualisht në këtë kompleks janë duke u zhvilluar punime të ndryshme për restaurimin e tërësishëm

të objektit. Përfundimi i projektit do të bëhet sipas afatit të kontratës dhe ky kompleks do të funksionalizohet së shpejti si muze i dëshmorëve.

Inspektorati mbyll lokalitë e lojërave të fatit në Vushtrri

VUSHTRRI, 26 TETOR (ER) - Policia e Kosovës ka bërë me dije se pas pranimin të një informate, ka kontrolluar një lokal në Vushtrri, ku ka takuar pesë persona duke luajtur lojëra të fatit. Gjatë kontrollit janë gjetur dhe janë konfiskuar: tre televizorë, tri

shtëpiza kompjuteri, tre monitorë dhe një skaner. Lokali është mbyllur nga inspektorët komunalë. Sipas policisë, lidhur me këtë rast është intervistuar i dyshuari mashkull kosovar dhe me vendim të prokurorit rasti shkon në procedurë të rregullt.



Fillon hapja e dy rrugëve të reja në Gurishtë të Malishevës

MALISHEVË, 26 TETOR (ER) - Në fshatin Gurishtë të Komunës së Malishevës ka filluar hapja dhe rregullimi i dy rrugëve, "Hazir Goriqi" dhe ajo e "Kolegjit". Në fillimin e punimeve në këto rrugë ishte i pranishëm edhe drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Ahmet Morina, i cili i ka uruar banorët e Gurishtës për rrugët e reja. "Sot kemi filluar hapjen dhe zgjerimin e këtyre dy rrugëve në Gurishtë dhe me këtë rast i

uroj të gjithë banorët e fshatit Gurishtë, në veçanti banorët e lagjeve që jetojnë në këto dy rrugë. Ne si komunë jemi të përkushtuar për realizimin e të gjitha projekteve, të cilat, në fakt, janë kërkesa dhe nevoja të banorëve, sikur janë edhe këto rrugë në Gurishtë", ka thënë drejtori Morina. Ai ka sqaruar se këto dy rrugë kanë një gjatësi prej 350 metrave dhe financohen nga buxheti i Komunës së Malishevës.








ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Do të paraqitemi mirë në ndeshjet e nëntorit

“Do të përpiqemi të kemi paraqitje sa më të mirë në çdo ndeshje. Ne e dimë se nuk do të jetë lehtë, por do ta japim maksimumin”, ka thënë Christos Marmarinos

PRISHTINË, 26 TETOR - Në muajin nëntor Kosova do të luajë ndaj Sllovakisë dhe Islandës në kuadër të parakualifikimeve për Kupën e Botës 2023. Këto dy ndeshje do të zhvillohen në Bratislavë të Sllovakisë. Përzgjedhësi i Kosovës në basketboll, Christos Marmarinos, i cili ka parë nga afër ndeshjet e Reload Superkupës, ka folur për sfidat e nëntorit. “Do të përpiqemi të kemi paraqitje sa më të mirë në çdo ndeshje. Ne e dimë se nuk do të jetë lehtë, por do ta japim maksimumin”, ka thënë

Marmarinos, i cili ka shtuar se pandemia ka ndikuar shumë në basketboll sikurse në çdo sferë tjetër të jetës. “Pandemia ka ndikuar në mbarë globin. E kemi parë edhe NBA, por edhe në të gjithat ligat, ku rezultatet nuk kanë qenë të pritura. Ne do të japim më të mirën tonë”, është shprehur Marmarinos për faqen zyrtare të FBK-së.

Ai foli edhe për ndeshjet që i përcjellë në Kosovë. “Ndeshjet ishin mjaft interesante dhe kompetitive. Kishte shumë rivalitet në fushë. Më pëlqeu një



lojtar, por nuk do t'ia them emrin”, ka shtuar më tutje përzgjedhësi i Kosovës. Por, cilat janë gjasat e Kosovës për ‘tu

kualifikuar në rrethin e ardhshëm. “Ne do të hyjmë ndeshje pas ndeshje dhe nuk do ta mendojmë kualifikimin tani.

Do të përpiqemi ta japim më të mirën. Sigurisht se nuk është lehtë, pasi 7 muaj nuk ka pasur basketboll dhe te të gjithë”, ka shtuar Marmarinos.

Kosova do të grumbullohet në Sllovaki më 23 nëntor, kurse ndeshjen me sllovakët do ta zhvillojë më 26 nëntor, kurse më 28 nëntor ballafaqohet me Islandën, takim që, po ashtu, zhvillohet në Sllovaki. Në muajin shkurt të vitit të ardhshëm, “dardanët” do të përballen me Luksemburgun dhe Islandën. Bordi i FIBA Evropës ka vendosur që ndeshjet e nëntorit të grupit të Kosovës të zhvillohen në Sllovaki, kurse më pas do të vendosë se ku do të zhvillohen ndeshjet e muajit shkurt të vitit 2021.

Krasniqi, e para në renditjen e re të IJF-së



PRISHTINË, 26 TETOR - Federata Ndërkombëtare e Xhudos (IJF) ka publikuar renditjen më të re olimprike. Pas garës së Grand Slamit të mbajtur në tri ditët e fundit në Budapest të Hungarisë, ekipi olimprik i Kosovës ka shënuar ngritje. Distria Krasniqi ka dalë e para në kategorinë deri në 48 kilogramë, pas medaljes së artë të fituar të premtën. Krasniqi mori 1 000 pikë të reja, duke çuar në 6 765 numrin e pikëve në total, me të

cilat la prapa dy herë kampionen e botës, Daria Bilodid. Lorian Kuka, që fitoi medaljen e bronzit, ka dalë e 13-ta me 3 463 pikë në kategorinë -78 kilogramë. Akil Gjakova është i 10-ti në kategorinë -73 kilogramë, duke tubuar gjithsej 3 447 pikë. Majlinda Kelmendi, e cila nuk mori pjesë në Grand Slamin e Budapestit, ndodhet e pesta me 4 152 pikë në kategorinë -52 kg. Të pesë xhudistët ndodhen brenda

normës olimprike Tokio 2020. Xhudistja Laura Fazliu, e cila po e kërkon normën olimprike, me pikët e fituara në Grand Slam, është ngritur për tetë vende, duke kaluar në pozitën e 55-të. Për ta fituar normën olimprike asaj i duhet të jetë diku në mesin e 30 xhudistëve në renditjen olimprike. Gara e ardhshme për ekipin olimprik është Kampionati Evropian, i cili mbahet prej 19-21 nëntor në Pragë të Çekisë.

Do ta mposhtim Ballkanin

PRISHTINË, 26 TETOR - Sulmuesi Alban Shillova është rikthyer nga lëndimi dhe është paraqitur rreth 25 minuta lojë në ndeshjen kundër Gjilanit. Sulmuesi pati një rast ideal që të shënojë gol, por gjuajtja e tij u ndalua nga portieri në formë të mirë, Enea Koliçi. Shillova është shprehur i kënaqur që është rikthyer, por është i zhgënjyer me humbjen e pësuar. “U ndjeva shumë mirë që u ktheva sërish në fushë, megjithëse kthimin e prisja edhe më herët, por lëndimi e bëri të veten. Gjithsesi do të ndihesha edhe më mirë dhe jo i zhgënjyer sikur do të

përfundonte rezultati ndryshe nga ai që përfundoi. Pata një rast ideal, por portieri Koliçi ishte thjesht i pamposhtur”, ka thënë Shillova për faqen zyrtare të klubit kryeqytetas. “Tani na pret ndeshja të mërkurën me Ballkanin. Mision i vështirë, por jo i paarrtshëm. Ne shkojmë për pikët e plota për çka kam besim të plotë në grupin e lojtarëve që kemi pasi këtë gjë e kanë dëshmuar me lojë. Neve na duhet të na përcjellë pak edhe fati më shumë, sidomos më shumë sesa në ndeshjen e djeshme”, ka shtuar Shillova.



Devolli paraqitet te Drenica

SKENDERAJ, 26 TETOR - Trajneri i ri i Drenicës, Bledar Devolli, është paraqitur të hënën në ambientet e klubit kuqezi, para bordit dhe

futbollistëve. “Devolli ka premtuar punë, disiplinë dhe angazhim për ta dërguar përpara KF Drenicën. Trajneri

nga Gjirokastra ka falënderuar ish-trajnerin Fadil Rama për urimin që ia bëri me rastin e emërimit të tij në stolin kuq e

zi”, thuhet në njoftimin e klubit nga Skenderaj. Trajneri Devolli zhvilloi menjëherë seancën e parë stërvitore me ekipin.



Berisha: Mbete në Serinë B për shkak të Covid-19

FERRARA, 26 TETOR - Covid-19 u bë pengesë që portieri i kombëtares shqiptare Etrit Berisha, i cili mbajti edhe shiritin e kapitenit në krah në dy sfidat e fundit, të transferohej në një skuadër të madhe dhe ky është pengu i gardianit kuqezi. Në një lidhje telefonike për emisionin Zona

Gol në Supersport, Berisha tregoi disa prapaskena të merkatos sa foli edhe për aventurën në Serinë B. "Seria B është diçka e re për mua. Me siguri se do të jetë një sfidë e rëndësishme në karrierën time. Gjithsesi duhet të kthehem aty ku e meritoj. Gjatë merkatos ka pasur interesim dhe mundësi

transferimi. Dëshira ime nuk është realizuar prej Covid-it. Një skuadër e madhe më ka mbetur peng. Ka pasur edhe disa ekipe të tjera që kanë qenë disi më inferiore", ka thënë Berisha. Një mendim i Berishës shkoi edhe për kombëtaren shqiptare, duke lënë të kuptohet se do të jetë e

vështirë që kombëtarja të ketë sërish një grup po aq të fortë sa ai që u kualifikua në "Euro 2016". "Grupi që kemi pasur me Shqipërinë, vështirë se do të bëhet ndonjëherë. Kemi shumë lojtarë të rinj që po inkuadrohen. Këto dy ndeshje kemi treguar karakter", u shpreh Berisha.



Real i kërkon fitoren e parë në Ligën e Kampionëve



"Epoka e re"

MADRID, 26 TETOR - Pas fitores në "El Clasico", Real Madridi është motivuar edhe më shumë që ta shijojë fitoren e parë në këtë edicion të Ligës së Kampionëve kundër skuadrës gjermane Borussia Moenchengladbach. "Los Blancos" pësoi një humbje tronditëse në shtëpi ndaj Shakhtar Donetskut në ndeshjen e parë të fazës së grupeve (2-3), kurse gjermanët mbetën baras me Interin me rezultat 2-2. Moenchengladbach në këtë ndeshje vjen pas barazimit në ndeshjen e parë në Ligën e Kampionëve dhe pas fitores që e mori të shtunën kundër Mainz 05 në Bundesliga (3-2). Kjo skuadër në dy herët që mori pjesë në këtë garë nuk arriti ta kalojë fazën e grupeve, por sonte do të kërkojë një rezultat tjetër pozitiv për ta ndjekur ëndrrën e kualifikimit. Në anën tjetër Real i Madridit arriti një fitore të madhe në "Camp Nou" kundër Barcelonës (1-3) dhe paraqitjen e mirë synon ta bëjë edhe sonte në Gjermani dhe ta shijojë fitoren e parë në këtë edicion në garën më të fortë në futboll. Vendësve do t'u

mungojnë Andreas Poulsen, Denis Zakaria dhe Laszlo Benes, ndërsa Mamadou Doucoure është në dyshim. Valentino Lazaro është rikthyer në stërvitje, por nuk ka luajtur që nga fundi i gushtit dhe vështirë se do të përfshihet në formacion. Ndërsa Marcus Thuram, Alassane Plea, Jonas Hofmann dhe Florian Neuhaus rikthehen në formacion pas pushimit në fundjavë. Mungesat e Realit janë Dani

Carvajal, Martin Odegaard, Mariano Diaz, Alvaro Odriozola dhe Nacho. Në Grupin B takohen edhe Shakhtar-Inter. Pikët e para dhe normalisht fitoren e synon edhe Atletioco Madridi që në ndeshjen e parë pësoi humbje të thellë nga Bayern Muncheni (4-0). Skuadra e Diego Simeones do të përballet me Salzburgun, kurse kampioni në fuqi i Evropës, Bayern Munchen, i shkon në Moskë, Lokomotivës.

GRUPI A		GRUPI C	
18:55 Lokomotiv M. - Bayern Munich 21:00 Atletico Madrid - Salzburg		21:00 Porto - Olympiacos 21:00 Marseille - Manchester City	
Tabela		Tabela	
1. Bayern M.	13 pikë	1. City	1
2. Lokomotiv M.	11	2. Olympiacos	1
3. Salzburg	11	3. Marseille	1
4. Atletico	10	4. Porto	1
GRUPI B		GRUPI D	
18:55 Shakhtar Donetsk - Inter 21:00 B.Moenchengladbach - Real Madrid		21:00 Atalanta - Ajax 21:00 Liverpool - Midtjylland	
Tabela		Tabela	
1. Shakhtar	1	1. Atalanta	1
2. Moenchengladbach	1	2. Liverpool	1
3. Inter	1	3. Ajax	1
4. Real	1	4. Midtjylland	1
	PIKË		PIKË
	3		3
	1		3
	1		0
	0		0

SHKURT

Berisha në formacionin e javës në Francë

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Valon Berisha, është zgjedhur në formacionin më të mirë të javës së fundit në Ligën 1. Mesfushori shqiptar pati një paraqitje të mirë në fitoren e Stade de Reimsit kundër Montpellierit (4-0). Gazeta më e madhe sportive në Francë, "L'Equipe", e vlerësoi paraqitjen e Berishës me notën shtatë dhe e ka përzgjedhur në 11-shën më të mirë të javës së tetë.

Ronaldo mund të dënohet, theu rregullat e Covid-19

Ylli i Juventusit, Cristiano Ronaldo, është duke u hetuar nga autoritetet italiane për thyerje të rregullave të pandemisë Covid-19, më herët gjatë muajit tetor. Lajmi është bërë me dije nga ministri italian i Sportit, Vincenzo Spadafora, i cili ka deklaruar: "Pa autorizimin e autoriteteve shëndetësore, unë mendoj se Cristiano Ronaldo i ka thyer rregullat e pandemisë Covid-19". "Cristiano nuk e ka respektuar protokollin dhe po zhvillohet një hetim për këtë. Virusi po na frikëson të gjithëve, andaj rregullat duhet të respektohen nga të gjithë", ka deklaruar Spadafora për "Rai Sport".

E paqartë e ardhmja e Guardiolaës

Skuadra e Manchester Cityt nuk e ka nisur në mënyrën më të mirë edicionin e ri futbollistik, prandaj largimi i trajnerit Pep Guardiola është shumë i mundur. Guardiola ka kontratë me Cityn deri në vitin 2021, por ende nuk e ka rinovuar. "Daily Mail" raporton se drejtuesit e Cityt tashmë kanë nisur bisedimet me trajnerin e Leipzigit, Julian Nagesmann për ta zëvendësuar Guardiolen.

Ndërroi jetë talenti 17-vjeçar i Cityt

Manchester City ka dhënë një lajm të dhimbshëm për të gjithë nëpërmjet faqes zyrtare. Klubi njofton se ka ndërruar jetë në moshën 17-vjeçare ish-lojtari i të rinjve, Zheremi Uisten. Pjesë e të rinjve të Cityt që nga 2010, Uisten shihej si një mbrojtës me të ardhme të madhe, por kjo është ndërprerë ditën e diel, kur ai ka ndërruar jetë. Shkaqet e vdekjes nuk bëhen të ditura, por të gjithë në klubin e Cityt dhe jo vetëm janë prekur nga ndarja nga jeta e mbrojtësit 17-vjeçar. "Familja e Manchester Cityt e ka mësuar me trishtim lajmin për vdekjen e ish-lojtarit të akademisë, Zheremi Uisteb. Ngushëllime të sinqerta familjes dhe miqve të tij. Jemi me ju në këtë kohë të vështirë për ju", thuhet në komunikatën e Cityt.

PSG-ja kërkon të "blindojë" Mbappen

Real Madridi e ndjek prej kohësh dhe nuk humbet asnjë rast për ta joshur Kylian Mbappen. Në krye të listës së blerjeve të klubit "los blancos" të gjitha pritshmëritë e shohin atë në Madrid duke nisur nga sezoni i ardhshëm. Që kjo të mos ndodhë, PSG-ja ka nisur kundërsulmin për të "blinduar" të ardhmen e atij që konsiderohet si një nga talentet më të mëdhenj të futbollit botëror. Sipas "L'Equipe", drejtori sportiv i klubit parizien, Leonardo, ka shtuar takimet me përfaqësuesit e futbollistit. Kontrata e Kylian Mbappes me kampionët francezë skadon në vitin 2022. PSG-ja kërkon ta zgjasë atë të paktën edhe për tri vjet.

Mourinho kritikon VAR-in

Teknologjia VAR po del të jetë problematike në botën e futbollit, me shumë vendime që po konsiderohen si kontradiktore. Probleme me VAR ka së fundmi edhe Jose

Mourinho, i cili ka thënë se kjo teknologji sjell vendime të papranueshme. Si referencë, 'Special One' ka marrë rastin e Ilkay Gundogan dhe Jordan Pickford. "Mendoj se vëmendja

është e bazuar në faktin se aty ka VAR. Pa VAR, situatat në fushë do të ndodhnin dhe gjyqtari bën gabime", ka thënë Mourinho. "Më njihni për disa vite, e kisha të vështirë t'i

pranoja gabimet njerëzore, por kam mësuar dhe në këtë moment unë gjithmonë pranoj fajin e gjyqtarit. Ajo që unë nuk pranoj janë gabimet e VAR-it", ka shtuar Mourinho.





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry
Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
Agjencia za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)

26.10.2020

Konkurs publik për dhënie në shfrytëzim dhe administrim të Inkubatorit të Biznesit në Parkun e Biznesit në Drenas

Bazuar në nenin 11 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2016 për Mënyrën e Themelimit, Funkcionimit dhe Administrimit të Inkubatorëve të Biznesit, Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, nën mandatin e saj ka mbështetur e NVM-ve dhe krijimin e ambientit të favorshëm për ushtrim të veprimtarisë së biznesit, andaj fton dhe inkurajon të gjithë personat fizik dhe juridik që të aplikojnë për marrjen në shfrytëzim dhe administrim të "Inkubatorit të Biznesit në Drenas".

Inkubatori i Biznesit gjendet në Parkun e Biznesit në Drenas (PBD), magjistratja Prishtinë – Pejë, në fshatin Korreticë e Epërme, Drenas.

Inkubatori i Biznesit ofron gjithsej 13 hapësira (zyra) të madhësive të ndryshme të gatshme për shfrytëzim dhe të pajisura me inventar themelor (tavolinë pune, karrige dhe dollap) në total prej 371.22 m².

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë personat fizik ose juridik të përcaktuar sipas Udhëzimit Administrativ nr. 15/2016 për Mënyrën e Themelimit, Funkcionimit dhe Administrimit të Inkubatorëve të Biznesit.

1. Kriteret teknike;

- Duhet të jetë i regjistruar në Republikën e Kosovës, si OJQ ose si shoqëri tregtare. Dëshmuar me kopjen e Certifikatës së Regjistrimit të OJQ-së ose të Biznesit;
- Vërtetim tatimor me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK;
- Vërtetimin nga Gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetime, kërkohet origjinali jo më i vjetër se 30 ditë;
- Dëshminë e xhirollogarisë aktive në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
- Kopjen e letërnjoftimit të personit/ve në emër të cilit/ve është i regjistruar Aplikuesi.

2. Kriteret vlerësuese për dhënie në shfrytëzim dhe administrim të Inkubatorit të Biznesit në PBD janë të poshtëshënuara:

- Duhet të ketë se paku tri (3) vite përvojë pune në zhvillimin dhe avancimin e bizneseve fillestare.
 - Dëshmi që ka ofruar trajnime, këshillime, hartime të dokumenteve të ndryshme për biznese (plan biznesi, marketing, kontabilitet etj). Dëshmuar me listën e bizneseve përfituese të nënshkruar dhe vulosur nga ana e aplikuesit (origjinal), deri në 40 pikë;
- Të ketë staf profesional në menaxhim dhe zhvillim të bizneseve fillestare.
 - Se paku dy (2) ekonomist/e me përvojë pune minimum 5 vjeçare të dëshmuar me CV dhe kontratë pune apo referencë për përvojën e tyre. Njëherit aplikuesi duhet të ketë kontratë apo marrëveshje paraprake për angazhimin e këtyre ekonomistëve në menaxhim dhe zhvillim të bizneseve fillestare, deri në 30 pikë;
- Planin e zbatimit për menaxhimin, administrimin dhe monitorimin e bizneseve fillestare të vendosura në inkubatorë.
 - Përshkruar në mënyrë kronologjike nga dy deri në katër faqe, deri në 30 pikë;

3. Vizita në Inkubator:

MTI/Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë, për të gjithë të interesuarit do të organizojë vizita në Inkubatorin e Biznesit në PBD, me qëllim që të njoftojë të interesuarit me hapësirat dhe madhësitë e zyrave, që ofron ky inkubator i Biznesit. Vizitat realizohen çdo të Enjte ora 09:00-11:00 gjatë periudhës së është i shpallur konkursi.

4. Afati i dhënies në shfrytëzim dhe administrim të Inkubatorit të Biznesit

Afati për dhënie në shfrytëzim dhe administrim të Inkubatorit të Biznesit në PBD është pesë (5) vite me mundësi vazhdimi edhe për pesë (5) vite tjera nëse shfrytëzuesi ka zbatuar në tërësi obligimet kontraktuese. Çmimi për m² është tri (3) euro për vit. Të gjitha obligimet dhe detyrimet do të nënshkruhet në kontratën e përbashkët: përfituesi (në cilësinë e qiramarrësit) dhe në anën tjetër MTI dhe Komuna e Drenasit (në cilësinë e qiradhënësit).

5. Vlerësimi i aplikacioneve

MTI së bashku me Komunën e Drenasit themelon Komisionin prej katër (4) anëtarëve (2 nga MTI dhe 2 nga Komuna) për vlerësimin e kërkesave/aplikacioneve sipas kriterëve të përcaktuara me këtë shprehje të interesit për dhënie në shfrytëzim dhe administrim të Inkubatorit të Biznesit në PBD.

6. Të drejta dhe obligimet e palëve

Të drejtat dhe obligimet e palëve, themeluesit të Inkubatorit të Biznesit në PBD dhe shfrytëzuesit të Inkubatorit të Biznesit të përzgjedhur përcaktohen me kontratë.

7. Tërheqja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Njoftimi për konkurs publik është i publikuar në ueb faqen e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë mti.rks-gov.net dhe kiesa.rks-gov.net. Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë sipas konkursit publik duhet të aplikojnë duke dorëzuar të gjithë dokumentacionin në zyrën e arkivit të Ministrisë në formë fizike në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Rr. Muharrem Fejza, Lagjja e Spitalit, p. n. Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës

Afati i fundit për aplikim është deri më datë 26.11.2020 në orën 16:00. Aplikimet pas afatit kohor nuk do të merren parasysh.

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara në këtë konkurs publik.

Address: Lagja e Spitalit N.N. Muharrem Fejza Str. - 10000 Prishtina, Kosova



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry
Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
Agjencia za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)

26.10.2020

Javni konkurs za davanje na korišćenje i administriranje Poslovnog inkubatora u poslovnom parku u Glogovcu

Na osnovu člana 11. stav 2. Administrativnog uputstva br. 15/2016 o načinu osnivanja, funkcionisanja i administriranja poslovnih inkubatora, Agjencia za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu (KIESA), koja funkcioniše u okviru Ministarstva trgovine i industrije, pod svojim mandatom ima podršku MSP i stvaranje povoljnog okruženja za obavljanje poslovnih delatnosti, stoga poziva i podstiče sva fizička i pravna lica da apliciraju za korišćenje i administriranje "Poslovnog inkubatora u Glogovcu".

Poslovni inkubator se nalazi u poslovnom parku u Glogovcu (PPG), autoput Priština – Peć, u selu Gornja Koretica, Glogovac.

Poslovni inkubator nudi ukupno 13 kancelarijskih prostorija (kancelarija) različitih veličina spremnih za korišćenje i opremljenih osnovnim inventarom (radni sto, stolica i ormar) ukupno 371,22 m².

Pravo na apliciranje imaju sva fizička ili pravna lica kako je utvrđeno Administrativnim uputstvom br. 15/2016 o načinu osnivanja, funkcionisanja i administriranja poslovnih inkubatora.

1. Tehnički kriterijumi;

- Mora biti registrovan u Republici Kosovo, kao NVO ili kao trgovinsko društvo. Dokazano kopijom Sertifikata o registraciji NVO-a ili Biznisa;
- Poreska potvrda kojom se potvrđuje da aplikant nema tekućih neizmirenih poreskih obaveza ili je u sporazumu o poravnanju duga sa PAK-om;
- Potvrda od strane Suda koja potvrđuje da ovlašćeno lice subjekta nije pod istragom, traži se original ne stariji od 30 dana;
- Dokaz o aktivnom tekućem računu u jednoj od banaka koje je licencirala Centralna banka Kosova;
- Kopija lične karte osobe na čije ime je aplikant registrovan.

2. Kriterijumi za procenu za davanje na korišćenje i administriranje poslovnog inkubatora u PPG su sledeći:

- Mora imati najmanje tri (3) godine radnog iskustva u razvoju i unapređenju početnih biznisa.
 - Dokaz da je pružao obuku, savetovanje, izradu različitih dokumenata za biznise (poslovni plan, marketing, računovodstvo itd.). Dokazano spiskom biznisa korisnika potpisano i pečatirano od strane aplikanta (original), do 40 bodova;
- Da ima stručno osoblje za upravljanje i razvoj početnih biznisa.
 - Najmanje dva (2) ekonomista sa radnim iskustvom od najmanje 5 godina dokazano CV-om i ugovorom o radu ili referencama o njihovom iskustvu. U isto vreme aplikant mora imati ugovor ili prethodni sporazum o angažovanju ovih ekonomista za upravljanje i razvoj početnih biznisa, do 30 bodova;
- Plan sprovođenja za upravljanje, administriranje i praćenje početnih biznisa koji se nalaze u inkubatorima.
 - Hronološki opis na dve do četiri stranice, do 30 bodova;

3. Poseta inkubatoru:

MTI/Agjencia za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu organizovaće posetu Poslovnog inkubatoru u PPG za sve zainteresovane strane kako bi obavestila zainteresovane o prostoru i veličinama kancelarija koje nudi ovaj Poslovni inkubator. Posete se realizuju svakog četvrtka 09:00-11:00 časova tokom perioda dok je objavljen konkurs.

4. Vremenski rok za davanje na korišćenje i administriranje Poslovnog inkubatora

Rok za davanje na korišćenje i administriranje poslovnog inkubatora u PPG-u je pet (5) godina sa mogućnošću produženja za još pet (5) godina ako korisnik u potpunosti izvrši ugovorne obaveze. Cena po m² iznosi tri (3) evra godišnje. Sve obaveze i dužnosti će potpisati u zajedničkom ugovoru: korisnik (u svojstvu zakupca), a sa druge strane MTI i Opština Glogovac (u svojstvu zakupodavca).

5. Vrednovanje aplikacija

MTI zajedno sa Opštinom Glogovac uspostavlja Komisiju od četiri (4) člana (2 iz MTI i 2 iz Opštine) za vrednovanje zahteva/aplikacija u skladu sa kriterijumima utvrđenim ovim izražavanjem interesa za davanje na korišćenje i administriranje Poslovnog inkubatora u PPG.

6. Prava i obaveze strana

Prava i obaveze strana, osnivača poslovnog inkubatora u PPG i korisnika odabranog poslovnog inkubatora određuju se ugovorom.

7. Preuzimanje i podnošenje aplikacija:

Obaveštenje o javnom oglasu objavljeno je na veb stranici Ministarstva trgovine i industrije mti.rks-gov.net i kiesa.rks-gov.net. Entiteti koji žele aplicirati u skladu sa javnim konkursom moraju aplicirati podnošenjem celokupne dokumentacije u kancelariji arhive Ministarstva u fizičkom obliku u Ministarstvu trgovine i industrije, Ul. Muharrem Fejza, Lagjja e Spitalit, b. b. Priština, 10000, Republika Kosovo.

Rok za apliciranje je do 26.11.2020. u 16:00 časova. Aplikacije primljene nakon roka neće se uzeti u obzir.

U trenutku apliciranja subjekt prihvata sve odgovornosti, obaveze, kriterijume i dužnosti predviđene u ovom javnom konkursu.

Address: Lagja e Spitalit N.N. Muharrem Fejza Str. - 10000 Prishtina, Kosova



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit- Kancelarija Premijera-Office Of The Prime Minister

Në mbështetje të nenit 7 të Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronës, dhe të nenit 8 të Rregullores nr.10/2017 për Detyrat, Përgjegjësit dhe Organizimin e Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, Zyra e Kryeministrit shpall:

KONKURS

Për Zëvendës drejtor të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Kriteret që duhet ti plotësojnë kandidatët për përzgjedhjen e Zëvendës drejtorit janë:

- Letër motivimi me shpjegime të qarta dhe shembuj nga provoja profesionale që tregojnë se si provoja dhe aftësitë përputhen me kërkesat e vendit të punës,
- Diplomë Universitare në fushën relevante,
- Së paku tetë (8) vjet përvojë pune profesionale të cilat së paku pesë (5) vjet përvojë në pozitën udhëheqëse,
- Të ketë aftësi të larta organizative dhe drejtuese,
- Të ketë aftësi të larta të komunikimit dhe negocimit,
- Të jetë njohës i fushës së të drejtës pronësore.

Zëvendës drejtori emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës pas propozimit nga Kryeministri me mandat pesë (5) vjeçar pa të drejtë rizgjedhje.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Kandidatët për Zëvendës drejtor të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, duhet të dorëzojnë këto dokumente.

CV-në e cila ofron shembuj të arritjeve në punë

Letër motivimi

Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës)

Certifikatën (dëshminë) që dëshmon se nuk është nën hetime

Shtetas i Republikës së Kosovës (kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit).

Dokumentacioni duhet të jetë në pliko (zarf) të mbyllur ku shkruhet emri dhe mbiemri si dhe emri i pozitës në të cilën konkurren kandidatit dhe të dorëzohen në Zyrën e Sekretariatit Koordinues të Qeverisë në Zyrën e Kryeministrit, Ndërtesa e Qeverisë, kati i I-rë, zyra nr. 100.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet, origjinalet mund të kërkohen nga komisioni përzgjedhës.

Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes telefonit 038/200 14 400.

Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor (nga data 27 tetor 2020 deri me 10 nëntor 2020).



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit- Kancelarija Premijera-Office Of The Prime Minister

Na osnovu člana 7 Zakona br. 05/L-010 o Kosovskoj agencije za poređenje i proveru imovine, člana 8 Uredbe br.10/2017 o zadacima, odgovornostima i organizaciji Izvršnog sekretarijata Kosovske agencije za poređenje i proveru imovine, Kancelarija premijera objavljuje:

KONKURS

Za zamenika direktora Izvršnog sekretarijata Kosovske agencije za poređenje i proveru imovine.

Kriterijumi koje trebaju ispuniti kandidati za izbor direktora i zamenika direktora su:

- Motivaciono pismo sa jasnim objašnjenjima i primerima iz stručnog iskustva koje pokazuje da iskustvo i sbosobnosti se poklapaju sa zahtevima radnog mesta,
- Univerzitetska diploma u relevantnoj oblasti,
- Najmanje osam (8) godina stručnog radnog iskustva, od čega najmanje pet (5) godina radnog iskustva na rukovodećem položaju,
- visoke organizacione i rukovodeće sposobnosti,
- Velike veštine komunikacije i pregovaranja,
- Poznavalac oblasti imovinskih prava.

Zamenika direktora imenuje Skupština Republike Kosova na predlog premijeram, na mandat od pet (5) godina, bez prava na reizbor.

OPŠTE INFORMACIJE ZA KANDIDATE O PROCEDURAMA KONKURISANJA

Kandidati za zamenika direktora Izvršnog sekretarijata Kosovske agencije za poređenje i proveru imovine treba da podnesu sledeće dokumente.

CV sa primerima dostignuća u radu

Motivaciono pismo

Dokumente predvidjene u uslovima zapošljavanja (dokaz o stručnoj spremi, radno iskustvo)

Uverenje (dokaz) koje dokazuje da nije pod istragom

Državljanin Republike Kosovo (kopija pasoša ili lične karte)

Dokumentacija treba da bude u zatvorenoj koverti u kojoj ja napisano ime i prezime i naziv pozicije za koju kandidat konkuriše i ista se dostavlja Kancelariji generalnog sekretara Kancelarije premijera, zgrada Vlade, I sprat, kancelarija br. 100.

Predata dokumentacija se ne vraća, originale može zatražiti komisija za selekciju.

Dodatne informacije možete dobiti putem telefona 038/200 14 400.

Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u dnevnom novinama (od 27.10.2020 do 10.11.2020 godine).

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "2 Korriku" Sh.p.k Soponicë, Kaçanik, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndryshimin e kapacitetit nga 1.3 MW në 3.75 MW të hidrocentralit në lumin Lepenc komuna e Kaçanikut.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën **20.11.2020** në ora **11:00** në hapësirat e parcelës Nr 17. e cila është në mes të punishtes, Rr. "Kongresi Manastirit" fshati Soponicë, Kaçanik do të organizohet debat publik nga kompania "2 Korriku" Sh.p.k Soponicë, Kaçanik, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndryshimin e kapacitetit nga 1.3 MW në 3.75 MW të hidrocentralit në lumin Lepenc komuna e Kaçanikut.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/82621596220?pwd=QINsQTBxMERaRU04cGhhYWZuTElWQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "2 Korriku" Sh.p.k Soponicë, Kaçanik për ndryshimin e kapacitetit nga 1.3 MW në 3.75 MW të hidrocentralit në lumin Lepenc komuna e Kaçanikut.

https://mmph.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publikimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Kosovar Leskovci shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Emin Duraku" Prishtinë.

► Marcel Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Jasir Avdyli shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Silver Shaipi shpall të pavlefshme diplomën e SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Drita Muçaj shpall të pavlefshme diplomën e SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Mitat Rakaj shpall të pavlefshme dëftesat e klasës: -VII- të shkollës fillore "Lekë Dukagjini", Prizren.

► Miranda Dedaqi shpall të pavlefshme dëftesat e diplomën dhe certifikatën e SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

